



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.10.2021, ora 09:00

#### Drejton mbledhjen:

**Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për marrëveshjen e huas ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a. (OSHEE), dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e OSHEE-së për reagimin ndaj krizës së pandemisë COVID-19".

2. Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për zbatimin e programit për përgatitjen e studimeve të fizibilitetit dhe hartimit në nivel përfundimtar dhe studimin e impaktit mjedisor në sektorin e infrastrukturave, ratifikuar me ligjin nr. 86/2016".

3. Shqyrtimi i projektvendimit "Për shpalljen e vakancës së katër anëtarëve të "Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit".

#### **Marrin pjesë:**

Klotilda Bushka, Klevis Xhoxhi, Fatmir Xhafaj, Ermonela Valikaj (Felaj), Saimir Hasalla, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Eduard Ndreca, Alqi Bllako, Arben Pëllumbi, Bardhyl Kollçaku, Lavdërim Krrashi, Oerd Bylykbashi, Gazment Bardhi, Enkelejd Alibeaj, Dhurata Tyli (Çupi), Saimir Korreshi, Greta Bardeli, Dashnor Sula, Fatmir Mediu, Aurora Mara, Elda Hoti, Jurgis Çyrbja dhe Erisa Xhixho.

#### **Mungojnë:**

Bledjon Nallbati, Damian Gjikhuri, Gerta Duraku, Toni Gogu dhe Gledis Çeliku.

**Të ftuar:**

Ilir Bejtja – Zëvendësministër në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Kledia Ngjela – Drejtoreshë e Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Elton Sevrani – Drejtor në OSHEE

Ardian Çela – Administrator i OSHEE-së

Brikena Jazxhi – Drejtore në Drejtorinë e Strategjisë dhe Monitorimit të Borxhit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Enkelejda Muçaj – Zëvendësministre në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Thimjo Plaku – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Teuta Balili – Drejtoreshë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Erald Elezi – Drejtor në ARRSH

## HAPET MBLEDHJA

**Klotilda Bushka** – Mirëmëngjesi, të nderuar kolegë!

Fillojmë mbledhje e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut me rendin e ditës si vijon.

Si pikë e parë kemi shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për marrëveshjen e huas ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a. (OSHEE), dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e OSHEE-së për reagimin ndaj krizës së pandemisë COVID-19".

Si pikë e dytë kemi shqyrtimin e projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për zbatimin e programit për përgatitjen e studimeve të fizibilitetit dhe hartimit në nivel përfundimtar dhe studimin e impaktit mjedisor në sektorin e infrastrukturave, ratifikuar me ligjin nr. 86/2016".

Si pikë e tretë kemi shqyrtimi i projektvendimit "Për shpalljen e vakancës së katër anëtarëve të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit".

Besoj se jeni dakord me rendin e ditës, siç jeni në dijeni, sepse materialet u janë shpërndarë.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Për të bërë prezantimin e këtij projektligji kemi ftuar zotin Ilir Bejtja, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë. Mirë se erdhe, zoti Bejtja!

Gjithashtu kemi ftuar zonjën Kledia Ngjela, drejtoreshë e Përgjithshme në këtë ministri, zotin Elton Severani, drejtor në OSHEE, zotin Teodor Veveçka, drejtor në OSHEE dhe zoti Ardian Çela, administrator i OSHEE-së.

Nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka konfirmuar pjesëmarrjen zonja Brikena Jazxhi, drejtoreshë në Drejtorinë e Strategjisë dhe Monitorimit të Borxhit.

Të nderuar të ftuar mirë se erdhët!

Ndërkohë, kolegëve të nderuar të komisionit u kujtoj që ne jemi komision për dhënie mendimi dhe relator do të jetë zoti Denis Deliu. Komisionit i kujtoj se kur jemi komision për dhënie mendimi ne shohim përputhshmërinë e projektaktit me Kushtetutën dhe harmonizimin e tij me legjislacionin.

Fjalën po ia kaloj zotit Bejtja që të na bëjë prezantim të nismës dhe më pas do të vijojmë sipas procedurës që parashikon Rregullorja e Kuvendit.

Zoti Bejtja, fjala është për ju.

**Ilir Bejtja** – E nderuara zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Vijmë sot këtu me këtë projektligj, i cili synon financimin e OSHEE grup me 70 milionë euro nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Edhe nga titulli, siç e shikoni, kjo lidhet me situatën e vështirë që ne kemi kaluar në periudhën e viti 2020 gjatë COVID-it, ku kemi pasur disa rezultate, të cilat kanë vështirësuar situatën financiare të shoqërisë, të cilat zoti Çela do t'i përmendë më vonë. Kredia përbëhet nga dy pjesë, njëra pjesë është 55 milionë dhe do të shërbejë për zbutjen e efekteve të pandemisë dhe pjesa tjetër është 15 milionë euro, e cila synon ndërtimin e një nënstacioni të ri në qendër të Tiranës, që do të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm urban të qendrës dhe do të balancojë konsumet, të cilat deri më tani kryesisht sigurohen nga unaza, pra rreth e qark, dhe balancohen me shumë vështirësi nga një nënstacion i përkohshëm, që ka qenë i ndërtuar më përpara në oborrin e Hotel Tirana Internacional.

Kredia ka filluar të negociohet në mars të vitit 2021 dhe ka marrë të gjithë kohën e duhur për të qenë në përputhje me Kushtetutën, siç ju e thatë, dhe për të kaluar të gjithë fazat e saj deri në këtë moment që jemi këtu përpara jush.

Vjen në një moment të vështirë, që lidhet me situatën e vështirë ndërkombëtare të krijuar për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë në një fazë kur ne për shkak të deformimit sezonal që kemi në prodhimin e energjisë në këto momente, përballojmë importe të larta për të garantuar 100% sigurinë e furnizimit me energji dhe kjo na bën të mundur që të lëvizim më lirshëm në garantimin e sigurisë së furnizimit, por edhe të cilësisë së furnizimit me energji. Kemi përpara dimrin, i cili mund të sjellë vështirësi të mëtejshme për shkak të sezonit dhe në këtë mënyrë ne jemi më të siguar.

Tani do t'ia lë fjalën zotit Çela që të bëjë një prezantim më të detajuar të kësaj kredie, sepse janë ata që e kanë negociuar dhe ministria i ka mbështetur gjatë negociatave.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Bejtja!

Zoti Çela, fjala është për ju.

**Ardian Çela** – Përshëndetje të gjithëve!

Zoti Bejtja tha që kjo kredi ka filluar në mars të viti 2021, por, në fakt, negociimin me BERZH-in e kemi filluar në verën e vitit 2020, kur ishim nën efektin e pandemisë.

BERZH-i, si një nga institucionet financiare, i cili e mbështet sektorin energjetik shqiptar, duke parë situatën e vështirë që po kalonte OSHEE-ja dhe të gjitha bizneset, si pjesë

e atij realiteti që kaloi jo vetëm vendi ynë, por i gjithë globi në vitin 2020, për shkak të efektit *lockdown* nga pandemia, u ofrua për të na dhënë këtë kredi prej 70 milionë eurosh me kohëzgjatje për 5 vjet dhe me interes kredie 1%.

BERZH-i vuri re që, për shkak të impakteve, të cilat unë do t'i sqaroj, që kishim për efekt të pandemisë dhe thatësisë, ishim të detyruar të ndërprisnim për të katërtin vit radhazi, por viti 2020 ishte më i theksuari, fondet e investimeve për të mbuluar nevojat për energji. Në mënyrë që OSHEE-ja të kthehej në mënyrë graduale në nivelin e investimeve dhe të kapte ritmin e tyre për të realizuar uljen e nivelit të humbjeve, sipas programit dhe të realizimit të treguesve të tjerë, ata na ofruan këtë kredi prej 70 milionë eurosh për pagesat për energjinë.

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike grup e mbylli vitin 2020 me një humbje prej 2,4 miliardë lekësh të rinj. Faktorët që ndikuan ishin disa dhe unë po i përmend.

Një faktor ishte ulja e nivelit të arkëtimeve, nëse deri në vitin 2019 nivelin e arkëtimeve ne e kishim në nivelin 97,5%, në vitin 2020 zbriti në shifrën 93,4%. Për sa u përket arsyeve, nëse doni po ua shpjegoj, por ishin më se objektive në kushtet e *lockdown*-it, pra mbylljes së familjarëve, pamundësia për të bërë lexime e të gjitha me radhë. Vetëm ulja e nivelit të arkëtimeve e impaktoi kompaninë me 2,7 miliardë lekë të rinj.

Gjithashtu, për shkak të vështirësive të *lockdown*-it kompania për herë të parë nuk arriti të realizojë planin e humbjeve në rrjet, i cili për vitin 2020 ishte 20% dhe ne ishim në shifrën e 21,48 %. Edhe këtu arsyet ishin më se objektive: ulja e nivelit të kontrolleve, mosrealizimi i leximeve, sepse stafi ishte i karantinuar apo i sëmurë dhe ishte e pamundur aksesimi nëpër shtëpi apo objekte për të bërë leximin. Pra, janë një sërë faktorësh objektivë.

Gjithashtu, edhe mosrealizimi i investimeve, sepse duke realizuar vetëm nivelin e investimeve në shifrën e 63%, që ishte realizimi më i ulët me 5,9 miliardë lekë që kemi bërë në 7 vjet, impakti ishte ky që thashë, dhe 1,48% niveli i humbjes që nuk u realizua, kishte një efekt prej 1 miliard lekësh të rinj.

Ka edhe një arsye tjetër, që është ndryshimi i strukturës së konsumit. Kjo do të thotë se ne kemi në nivel konsumi, ku 54% e zënë konsumatorët familjarë që tarifohen me 9,5 lekë, por kjo tarifë është e subvencionuar, sepse çmimi mesatar është 10,7, por në vitet 2019-2017 ka shkuar në 12 lekë, sepse kanë qenë vite të thata dhe kostoja e energjisë nuk u mbulua nga prodhimi i KESH-it për pamundësi objektive, kështu që nuk ishte më 1,5 lekë, por ishte në treg të lirë që ka një impakt të caktuar.

Konsumi në tarifën 9,5 në vitin 2020 shkoi nga niveli 54% në nivelin e mbi 58%, sepse të gjithë e dimë se aktivitetet ekonomike ishin të mbyllura, njerëzit ishin në shtëpi, konsumi u

rrit, madje edhe në total konsumi u rrit me 7%, por u rrit kjo pjesë e subvencionuar. Vetëm ky impakt i impaktoi financat e kompanisë me 938 milionë lekë të rinj.

Për të gjitha këto, plus rritja e shpenzimeve për blerje energjie për të katërtin vit radhazi nga viti 2017-2018-2019-2020 KESH-i nuk mundi të garantojnë sasinë e nevojshme të energjisë që duhet të furnizojë shërbimit universal. Për ta shpjeguar më gjatë, OSHEE-ja garanton çmimin 9,5 për familjarët, 11-12 për bizneset dhe 14 për bizneset që punojnë me tension të ultë, duke parë disa prej kritereve, një prej kritereve është që sasia prej 4 terash duhet të garantohet nga prodhimi i KESH-it me çmimin 1,5 lekë. Në rast se ndryshon, pra nuk realizohet ky kriter, OSHEE-ja duhet ta sigurojë në tregun e lirë. Kjo do të thotë se tarifa në fund nuk del më 9,5, por ndryshon. I gjithë ky gap i OSHEE-së në 4 vjetët e fundit, e cila e ka mbajtur vetë, duke blerë në tregun e lirë, është impaktuar në katër vjet me 200 milionë euro, sepse në vitin 2017 impaktin e ka pasur 65 milionë euro, 74 milionë euro në vitin 2019 dhe 55 milionë euro në vitin 2020 për pamundësi të prodhimit të KESH-it, sepse KESH-i ka arritur të garantojë vetëm 2,9 tera dhe 45% dhe 2,2-2,5 çdo vit OSHEE-ja e ka blerë në tregun e lirë. Vetëm për vitin 2020 ky impakt ishte 4,5 miliardë lekë të rinj.

Pra, i rendita të gjithë këta tregues për të treguar që edhe impakti në vitin 2020 për periudhën e COVID-it kapi shifrën 9,7 miliard lekë. BERZH-i e ka analizuar për një kohë të gjatë këtë situatë, ka realizuar edhe mundësitë financiare dhe performancën e kompanisë dhe na u afruan në një kredi pa kushte disbursimi, thjesht për të paguar pagesat e energjisë, për të cilët në ishim imparkuar nga pamundësia e paguesve vendas dhe ishim të orientuar në tregun e lirë. Por kërkesa jonë ishte që gjithë kjo kredi të mos përdorej për likuidimin e kredisë, pra OST- KESH dhe HEC-et private, por kërkuam të asistonte edhe për ndërtimin e nënstacionit të qendrës, sepse është i një teknologjie të re dhe të paimplementuar jo vetëm në Shqipëri, por edhe në të gjithë rajonin. Do të jetë një nënstacion nëntokësor ,i pozicionuar në qendrën e Tiranës dhe do t'i shërbejë zhvillimit të qytetit në 30 vjetët e ardhshëm, sepse do të zëvendësojë nënstacionin ekzistues, që është ndërtuar pas Hotel Tiranës në vitin 1998 dhe ka qenë një nënstacion provizor. Megjithëse kanë kaluar 23 vjet, ai vazhdon të jetë aty. Nënstacioni i ri do të jetë me shumëfishin e fuqisë që ka tani ekzistuesi, por do të ofrojë edhe disa shërbime të tjera teknike, që balancuesi i ngarkesave dhe shumë gjëra të tjera teknike që ndoshta nuk janë objekt i kësaj tryeze. E kërkuam suportin e BERZH-t për këtë proces, sepse, duke pasur garancinë dhe prezencën e BERZH-it, donim të garantonin një proces sa më transparent dhe të kishim mundësi pjesëmarrjen e kompanive ndërkombëtare më me emër për të pasur rezultat të suksesshëm në ndërtimin e këtij projekti, i cili do të realizohet për herë të parë në Shqipëri, por edhe në të gjithë rajonin.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit!

Fjala për relatorin zotin Deliu.

**Denis Deliu** – Përshëndetje!

E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për marrëveshjen e huas ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për projektin e OSHEE-së për reagimin ndaj krizës së pandemisë COVID-19.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut e shqyrton atë në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit. Komisioni përgjegjës për shqyrtimin e projektligjit është Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Vlerësimi i ligjshmërisë, kushtetutshmërisë dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi vendas e ndërkombëtar

Këshilli i Ministrave e ka propozuar projektligjin bazuar në nenet 78, 83, pika 1, dhe nenit 121, pika 1, të Kushtetutës, në përputhje me nenet 81, pika 1, dhe 100 të Kushtetutës, si dhe me nenin 17 të ligjit nr.43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Projektligji është në harmoni me të gjithë rendin juridik të brendshëm dhe veprimtaria e tij nuk bie ndesh me fushën e veprimtarisë së ndonjë institucioni tjetër.

Marrëveshja e garancisë duhet t’i nënshtrohet procedurës së ratifikimit nga Kuvendi në përputhje me nenin 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës.

*Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit*

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për marrëveshjen e huas ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për projektin e OSHEE-së për reagimin ndaj krizës së pandemisë COVID-19. Marrëveshja e huas dhe marrëveshja e garancisë, që janë nënshkruar me BERZH-n më 8.9.2021 kanë si qëllim sigurimin e fondeve në formën e kredisë me terma të favorshëm, për të mbështetur kompaninë për sigurimin e stabilitetit ekonomik – financiar, në vlerë të përgjithshme deri në 70 000 000.00 (shtatëdhjetë milionë) euro.

Ky financim synon rritjen e performancës së OSHEE Group, sh.a.-së, duke i mundësuar shoqërisë likuiditet të nevojshëm me anë të mbështetjes nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, me një kredi prej 70 milionë eurosh, me kusht që të ketë garancinë e Republikës së Shqipërisë. Nëpërmjet marrëveshjes së garancisë së nënshkruar dhe që synohet të ratifikohet me anë të këtij projektligji, Republika e Shqipërisë garanton të gjitha detyrimet që Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group, sh.a. merr përsipër nëpërmjet marrëveshjes së huas që lidhet ndërmjet BERZH-it dhe OSHEE Group, sh.a.-së. Në lidhje me lëshimin e kësaj garancie është lidhur, gjithashtu, marrëveshja e mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe OSHEE Group, sh.a.-së në përputhje me kuadrin ligjor që rregullon huamarrjen, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas.

Ky financim përbën një detyrim të drejtpërdrejtë për OSHEE sh.a., kundrejt BERZH-it dhe, në rast të pamundësisë për të shlyer detyrimet nga OSHEE-ja, detyrimet e kredisë paguhen nga buxheti i shtetit, mbështetur në marrëveshjen e garancisë.

Projektligji nuk synon përafrim me ndonjë *acquis* të BE-së.

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektligji janë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe OSHEE, sh.a..

Faleminderit!

Ky ishte një relacion i shkurtër dhe i ftoj kolegët ta miratojmë këtë ligj!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit!

Kolegë ju ftoj të bëni pyetje dhe diskutime bashkë meqenëse është marrëveshje dhe jemi komision për dhënie mendimi.

Zoti Mediu ka kërkuar fjalën, më pas zoti Korreshi.

**Fatmir Mediu**- Faleminderit!

Unë kam disa pyetje:

Së pari, sa është borxhi që i kanë OSHEE-së entet publike dhe institucionet shtetërore, i krahasuar edhe me kredinë? Nëse diferenca është e njëjtë ose më e madhe, si mund të bëhet që të detyrohen institucionet shtetërore dhe entet publike të paguajnë detyrimin që kanë ndaj OSHEE-së, ashtu siç u detyruan konsumatorët? Sepse të vijë shteti të marrë borxh në emër të OSHEE-së për të larë borxhet e veta, duke ia faturuar ato OSHEE-së nuk ka kuptim.

Së dyti, ju keni furnizuesin e tregut të lirë, i cili bën edhe shitjen e energjisë elektrike. Në dijeninë time Maqedonia dhe Kosova e shesin këtë në bursë, kurse furnizuesi i tregut të lirë e bën nëpërmjet kërkesave që vijnë në forma të ndryshme, si *e-mail* e të tjera. Pse është ky lloj disproporcioni ndërmjet veprimit të këtyre dy vendeve, të cilat tregojnë më shumë transparencë, por edhe eficiencë në raport me atë që ndodh me FDL-në në Shqipëri.



Po ashtu, ka një diferencë shumë të madhe ndërmjet çmimit të shitjes në një periudhë të caktuar, që ka qenë rreth 15 euro megavat/orë, me çmimin e blerjes që sot, në tetor, sipas asaj që unë shikoj nga informacioni, arrin deri në 383 euro.

Po ashtu, një konstatim është se, ndodh që OSHEE-ja e blen energjinë nga KESH-i nëpërmjet privatëve, sipas informacioneve që kam, të cilët garantojnë të ardhura të konsiderueshme, në një kohë që OSHEE-ja mund ta blinte edhe vetë, drejtpërdrejt nga KESH-i, duke qenë edhe brenda të njëjtit sistem, brenda të njëjtit interes.

Ajo çfarë dua të ngre si shqetësim në fund fare, sepse kjo është një histori që përsëritet me vite e vite, është detyrimi që ka OSHEE-ja për t'i vendosur si të barabartë përballë ligjit si institucionet publike, entet shtetërore e ato private. Pra, nuk mund të kenë status të privilegjuar entet shtetërore e publike, ndërsa privatët nga ana tjetër, për shkak të veprimit represiv të shtetit, të jenë të detyruar të paguajnë. Padyshim, të gjithë duhet të paguajnë, por çështja është se në radhë të parë duhet të paguajë ai që ka në dorë ligjin, ai që ka në dorë edhe menaxhimin e marrëdhënieve dhe financat e këtij vendi.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Mediu!

Atëherë, do t'i mbledhim të gjitha pyetjet e më pas do t'jua jap fjalën juve, përfaqësuesve të ministrisë dhe të OSHEE-së.

Zoti Korreshi.

**Saimir Korreshi** – Faleminderit!

Atëherë, pak a shumë pyetja ime ka lidhje me atë që tha edhe kolegu, fatmiri, por unë do të doja të dija më specifikisht se sa është shuma që OSHEE-ja i ka Ujësjellës-Kanalizimeve, si dhe pse ka dështuar skema e mbledhjes së borxheve, duke qenë se këta operojnë në një...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, pse ka dështuar, duke qenë se operojnë edhe si shoqëri aksionere. Në dijeninë time, këta nuk po lënë njeri pa u sekuestruar të gjitha llogaritë, pavarësisht detyrimeve. Sepse ju po mblidhni taksën e televizorit dhe s'po ua mblidhni dot Ujësjellës-Kanalizimeve. Pse? Sa është shuma në total? Sepse, në dijeninë time, Ujësjellës-Kanalizimet po i shpërndajnë këto për rrogat. Kanë emëruar pa fund njerëz, para fushatës, por edhe po vazhdojnë të emërojnë, se po i ndajnë përgjysmë rrogat. Pse ka dështuar skema e mbledhjes së borxheve të Ujësjellës-Kanalizimeve, duke qenë se operojnë si shoqëri aksionerë? Sa është shuma totale e këtyre që i kanë OSHEE-së, në total, të gjitha? Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Korreshi!

Pyetje të tjera? Jo.

Atëherë, zoti Bejtja, zoti Çela, fjala është për ju, për përgjigjet.

Ah, në rregull!

Po, zoti Sula.

**Dashnor Sula** – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë e kam pyetjen të drejtpërdrejt për drejtorin e OSHEE-së. Ndoshta drejtorit të OSHEE-së apo ndokujt tjetër këtu mund t'i duket pyetje e çuditshme, si dhe çudira të tjera që kanë ndodhur në Shqipëri, por që më pas kanë rezultuar të vërteta, nëse është drejtuar një pyetje apo ka ndodhur një ngjarje, të cilën ju e keni kundërshtuar gjithmonë.

Pyetja ime është e drejtpërdrejtë. Duke qenë se OSHEE-ja ka një kontroll total të territorit të Republikës së Shqipërisë për sa i përket harxhimit apo vjedhjes së energjisë elektrike nga subjekte të ndryshme, qoftë nga shtetas apo persona juridikë e fizikë, a keni informacion apo a keni vënë re që në zona të caktuara të Republikës së Shqipërisë ka një rritje të jashtëzakonshme, do të thosha, të harxhimit të energjisë elektrike, e që thuhet se ka filluar prodhimi ilegal i bitcoin-it në Shqipëri?

**Klotilda Bushka** – Zoti Bardhi, a keni pyetje?

Urdhëro!

**Gazment Bardhi** – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, unë kam dy pyetje. Pyetja e parë: besoj se ky nuk është borxhi i parë që merr OSHEE-ja, sigurisht me garanci nga buxheti i shtetit, ndaj unë do të doja të dija se sa ka qenë borxhi i paguar nga buxheti i shtetit për llogari të kredive që OSHEE-ja ka marrë në pesë vjetët e fundit?

Pyetja e dytë: a ka pasur një auditim kompania juaj, dhe a është konstatuar dëm financiar, abuzim me fondet e kompanisë? Specifikisht, do të isha i interesuar të dija se me sa përqind të fondeve limit jepen tenderët në kompaninë tuaj? Sa janë kompanitë në pesë vjetët e fundit? sa janë kompanitë që marrin pjesë në tenderët që organizon OSHEE-ja dhe me çfarë vlere fitohen këta tendera në raport me fondin limit? Kjo për të kuptuar se sa kurseni ju në shpenzimet që bëni apo në tenderimet që kryeni?

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit!

Zonja Bardeli, keni pyetje edhe ju? Po. në qoftë se doni ta bëni tani...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord! Po, po, dakord, zonja Bardeli! Urdhëroni! Fjala për ju!

**Greta Bardeli** – Ju falemnderit, zonja kryetare!

Në fakt, kjo marrëveshje ka ngjallur shumë debate dhe shqetësime sa u përket qytetarëve, e jo vetëm, por edhe kësaj opozite. Gjithsecili nga ne ka dyshimet e veta në lidhje

me transparencën e munguar, sa i përket përdorimit të këtyre fondeve dhe shërbimeve ndaj qytetarëve.

Si përfaqësuese e qarkut Shkodër, më shqetëson fakti se në këtë qark ka mungesë të energjisë elektrike në mënyrë të vazhdueshme. Para dy ditësh kemi pasur një mungesë të energjisë elektrike mbi shtatë orë. Këtu do të ndalem pak, për të denoncuar një fakt, të cilin edhe zotërinjtë e ministrisë mund ta dinë fare mirë: aty ka një amortizim të rrjetit të energjisë elektrike, pra të rrjetit shpërndarës, ka një amortizim të theksuar të kabinave elektrike, të cilat kanë prekur investimet vetëm gjatë fushatës elektorale. Pra, janë bërë investime të vogla e të izoluara vetëm gjatë fushatës elektorale.

Një shqetësim tjetër i vazhdueshëm, që shfaqet tashmë, është edhe paaftësia e disa zotërinjve, të cilët janë punësuar aty vetëm për shkaqe politike, si dhe njerëz të paaftë që nuk u japin drejtim problematikave e situatave si ajo e para dy ditëve.

Kështu që, largimi i profesionistëve nga ky institucion sjell një dëm të theksuar në mirëmbajtjen e këtij rrjeti.

Ju faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit!

Po, zoti Gogu!

U kërkohet kolegëve të fokusohen në çështjen e rendit të ditës. Po flasim për me një marrëveshje për OSHEE-në, kështu që le të fokusohemi në këtë çështje. Të gjitha shqetësimet që ju ngrini me të drejtë, në lidhje me zonat, pa diskutim që mund t'i bëjmë edhe në formën e pyetjeve dhe t'ua japim përfaqësuesve që vijnë në komision, për të marrë përgjigje më të plota, dhe jo thjesht për t'i ngritur si shqetësime. Mund t'i ndjekim në vijimësi si çështje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, zonja Bardeli, sepse nuk keni pse të komentoni atë që them unë.

Zoti Gogu e ka fjalën.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord!

Më falni, vetëm një sekondë, që t'ju sqaroj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Thjesht në cilësinë e kryetares, unë po ju them që të merremi me çështjet e rendit të ditës. Nuk po ju them se çfarë duhet të flisni. Thjesht po ju tërheq vëmendjen.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ka diçka për të shtuar zonja Bardeli.

**Greta Bardeli** – Meqenëse ju thatë se ky është një komision për dhënie mendimi, ky është një komision, i cili duhet të prekë çdo rast që sjell shqetësime ndaj qytetarëve, se për këtë jemi votuar dhe për këtë pjesë jemi këtu.

Ky është një shqetësim shumë alarmant. Po merret një borxh, i cili do të rëndojë në xhepat e qytetarëve dhe në fund të ditës do të jenë qytetarët dhe të gjithë ne këtu që do ta paguajmë këtë borxh. Më falni, nëse këto shqetësime që ne ngremë, nuk janë të rëndësishme, atëherë përse jemi mbledhur këtu? Po merret një borxh dhe në fund këtë borxh do ta paguajnë qytetarët e Shkodrës dhe të të gjithë Shqipërisë. Kur bëhet fjalë për një rrjet të amortizuar dhe për njerëz të paaftë, a

nuk është ky një shqetësim?! Të lihet një qytet si Shkodra 7 orë pa drita, nuk është shqetësim ky?!

Më falni, por, atëherë jemi të gabuar secili prej nesh në këtë pozicion!

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit!

Sa për një sqarim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Mediu, do t’jua jap fjalën.

**Fatmir Mediu** – Deputetët flasin në aspektin kushtetues dhe ligjor, të lidhur edhe me shqetësimet e mbarëvajtjes së kompanive, të shtetit apo edhe interesave të qytetarëve.

**Klotilda Bushka** – Jam shumë dakord me ju, dhe kam përshtypjen se nuk isha e qartë kur u shpreha ose ndoshta ju nuk më dëgjuat. Ju thashë që të fokusohemi në rendin e ditës. Sigurisht, keni të drejtë për çdo shqetësim që keni për zonat, por ju thashë që do t’i ndjekim shqetësimet në vijim edhe më shumë se kaq, mund t’i bëjmë edhe pyetje me shkrim për të na ardhur përgjigjet. Kështu që, më dëgjoni deri në fund dhe pastaj mund të diskutojmë.

Atëherë, fjala për zotin Toni Gogu.

**Toni Gogu** – Zoti zëvendësministër dhe zoti drejtor, shumë faleminderit për parashtrimin tuaj!

Ju përmendët që janë dy faktorë të jashtëm kryesisht, të cilët kanë ndikuar në vlerësimin tuaj për t’iu drejtuar tregut për të kërkuar dhe negociuar një kredi. Në faktorin e parë të jashtëm ju përmendët COVID-19, i cili ka impaktuar jo vetëm kompaninë tuaj, por të gjitha kompanitë e rruzullit tokësor.

Pyetjet e mia kanë të bëjnë me efektet që ka sjellë COVID-19 në rezultatin financiar të kompanisë.

Pyetja e parë: si ka ndikuar COVID-19 në uljen e arkëtimeve dhe në strukturimin e detyrimeve?

E dyta: si ka ndikuar COVID-19 (për shkak se ju parashtuat se ka pasur një plan) për të eliminuar humbjet? A keni arritur ta realizoni planin tuaj lidhur me humbjet?

E treta: ju kishit parashikuar të realizoni investime, në mënyrë që të përmbushni qëllimin kryesor për të cilin ekziston operatori, që është sigurimi i energjisë së pandërprerë për qytetarët. Si ka ndikuar COVID-19 në realizimin e këtyre investimeve?

E katërta: cili është rezultati financiar i kompanisë në 6 muajt e parë të këtij viti? Dua të kuptoj se si kompania ka menaxhuar performancën e saj gjatë pandemisë.

Pyetja e fundit është: lidhur me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, cili ka qenë vlerësimi financiar i kësaj banke në lidhje me performancën e kompanisë dhe me nevojën që kompania ka shtruar për t'u pajisur me kredi?

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Gogu!

Zonja Erisa, ka kërkuar fjalën.

**Erisa Xhixho** – Faleminderit, kryetare!

Sot po diskutojmë një çështje shumë sensitive për qytetarët. Në këtë krizë energjetike të supozuar, por që me sa kemi pasur mundësinë të diskutojmë dhe të dëgjojmë ekspertët, nga analiza e tyre del që ka më shumë një krizë menaxhimi, sesa një krizë energjetike me të cilën përballet vendi. Meqë jemi diskutuar për marrjen e një kredie, pa dyshim, që siç e tha edhe kolegja, do të rëndojë taksapaguesit shqiptarë, ndërkohë që ne kemi trumbetuar reforma shumë të thella në këtë sektor, mbaj mend 38 mijë qytetarë që kanë përfunduar në burg, pasi nuk kanë paguar dot tarifën e energjisë elektrike apo reforma të tjera që do të supozoheshin të bëheshin, pikërisht për të menaxhuar kriza, për të mos pasur kjo kompani mundësinë apo detyrimin për të marrë borxh, apo edhe në shumë analiza të ekspertëve, duke mos dashur të bëj ekspertin, por edhe si qytetare dhe në të gjitha diskutimet që ne kemi me qytetarët shtrohet pyetja: pse na është dashur të shesim më lirë dhe të blejmë më shtrenjtë gjatë muajve korrik-gusht-shtator dhe sot do të duhet të blejmë shumë më shtrenjtë energjinë elektrike, ndërkohë që e kemi shitur shumë lirë?

Të gjitha këto shqetësime i ngre, sepse në momentin që ndërmarrim reforma, i kemi çuar qytetarët edhe në burg, se nuk kanë paguar një pagesë të caktuar të energjisë elektrike, sot u themi qytetarëve që do të marrim sërish një borxh, pasi kompania është në vështirësi (ashtu siç e shtruat) edhe për shkak të pandemisë dhe gjithë faktorëve objektivë që nuk i dyshoj. Duhet të ketë një reflektim nga kompania dhe nga kjo qeveri, për mënyrën se si e ka menaxhuar këtë

kompani dhe se si i detyron sërish qytetarët shqiptarë të marrin borxh, të cilët, pa dyshim, do të duhet t'i paguajnë dhe të shlyejnë këtë detyrim me taksat tona dhe nuk do të jetë kjo kompani.

Mendoj se ka njëfarë përgjegjësie për të gjithë atë armatë njerëzish që u është dashur të vuajnë edhe burgun dhe situata jo shumë të lehta në muajt e kaluar, të vihet sot e t'u thuhet: "Prisni, se ne duhet të marrim kredi, pasi nuk mund të përballojmë krizën e pandemisë".

Pyetja ime shtrohet: a ka përgjegjësi kompania për këtë krizë menaxhimi dhe pse na është dashur, gjithashtu, të blejmë energji elektrike shumë shtrenjtë, ndërkohë që e kemi shitur shumë më lirë?

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Kam edhe unë një pyetje të fundit. Kreditë e BERZH-it janë kredi, të cilat kalojnë një proces skanimi, verifikimi dhe kryesisht bëhet fjalë sa u takon kriterëve të bazës së shoqërisë se sa e aftë është ajo që, nëpërmjet një kredie të marrë, të arrijë të jetë e aftë për ta kthyer kredinë sipas parashikimeve që ka kontrata.

Në fakt, kur BERZH-i miraton kontrata, sigurisht me të gjithë ata që mund të jenë palë të marrëveshjes, por kryesisht me kompanitë shtetërore, kriteret janë edhe më të forta akoma. Fakti që BERZH-i ka besuar që të lidhë këtë marrëveshje me OSHEE-në është një tregues që kompania i ka të shëndetshëm treguesit si një kredimarrës i mirë të BERZH-i. Ata kanë rregulla shumë të forta, në fakt, për këto lloj kredidhëniesh. Ajo që dua të di është: sa është niveli i arkëtimit krahasuar me vitin 2014? Unë e kam lënë sektorin me këto shifra, nuk i jemi kthyer më, sepse edhe në komision nuk e kemi pasur këtë gjë, ka qenë 48%. Nuk e di, sa është sot arkëtimi?

Sa i takon humbjeve, mbaj mend në vitin 2017 ne kemi bërë një analizë të ndërmarrjes për të kuptuar se sa ka qenë niveli i humbjeve. Kishim arritur të ulnim nivelin e humbjeve në vitin 2017, për 4 muaj të po këtij viti. Në sajë të një marrëveshjeje politike OSHEE-ja nuk u drejtua nga drejtori i asaj kohe dhe po të shohim treguesit, ka pasur një rritje të nivelit të humbjeve për 4 muajt e vitit 2017. Aty është momenti kur unë i kam lënë të dhënat e kompanisë, se nuk kemi pasur ndonjë çështje në komision. Dua të di sa është sot niveli i humbjeve krahasuar me vitin 2013?

Faleminderit!

Zoti Ndreca, keni pyetje?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Bejtja dhe zoti Çela, keni të drejtën...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Urdhëroni, zoti Ndreca!

**Eduard Ndreca** – Falënderoj shumë zëvendësministren dhe drejtorin për shpjegimet që na bënë për kredinë!

Kam një pyetje. Sa është niveli i vjedhjes dhe i humbjes së energjisë në rrjet? Kjo është një plagë e vazhdueshme që e shqetëson vazhdimisht OSHEE-në, prandaj dua të di, a ka ndonjë plan OSHEE-ja për të shtrënguar rripat dhe për ta minimizuar këtë nëpërmjet sistemeve kabllore të linjave?

Në të gjithë zonën time kam parë se në linjat ku është bërë ndërhyrje serioze nga ana e OSHEE-së, nëpërmjet sistemit kabllor, niveli i vjedhjes është minimizuar, por edhe rrjeti nuk ka pasur probleme dhe zonat janë furnizuar vazhdimisht me energji elektrike.

Kam edhe një konstatim, sepse askush nuk është futur në burg për vjedhje, për mospagesë energjie, por janë marrë masa ndaj atyre që e kanë vjedhur energjinë elektrike, këtë më duhej t’jua thosha, sepse vjedhja është vjedhje dhe besoj se është e dënueshme.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Fjalën e ka zoti Qefalia.

**Xhemal Qefalia** – Meqenëse e morën fjalën shumë përfaqësues të qarqeve, unë do ta merrja si përfaqësues i qarkut të Tiranës dhe do të sillja në vëmendjen tuaj një histori që ka ndodhur para disa vitesh, kur drejtonte opozita e sotme. U përurua një nënstacion këtu në Tiranë, u pre shiriti dhe qytetarët e Tiranës atë ditë nuk patën drita, duke u shprehur se në vend që të prisnin shiritin kanë prerë kabllon. Në këtë kontekst kisha një pyetje për zëvendësministrin dhe drejtorin, si përfaqësues i qarkut të Tiranës. Në vitin 1998 është ndërtuar nënstacioni te 15-katëshi, ndërkohë që ju thatë se me këto fonde do të shihet mundësia për të ndërtuar një nënstacion të ri. Dua të di se cila do të jetë fuqia në krahasim me nënstacionin ekzistues?

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Qefalia!

Zoti Bejtja dhe zoti Çela do ta organizoni vetë mënyrën se kush do të përgjigjet prej jush.

Po, zoti Çela.

**Ardian Çela** – Borxhi që ka Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike është 20,3 miliardë lekë të reja, ndërkohë me këtë rast merr përgjigje edhe zotëria tjetër që pyeti, ku 17,3 miliardë lekë është borxhi i ujësjellësve dhe i jobuxhetorëve, ku te jobuxhetorët në mënyrë të detajuar përfshihet ARMO me 2,4 miliardë lekë. Këtë më duhet t’jua sqaroj, sepse situata tek ARMO ka një problematikë që nuk zgjidhet prej më shumë se 10 vjetësh, sepse që në momentin që është privatizuar, ARMO është privatizuar me gjithë nënstacionin dhe aty ka një konflikt

ndërmjet bashkisë së Ballshit dhe fabrikës për të njohur debinë e ujësjellësit. Për këtë jemi edhe në proces gjyqësor, por ka një radhë në procesin gjyqësor për sekuestrimin e nënstacionit, dhe këtu nuk jemi vetëm ne.

Pra, si në rastin e ARMO-s edhe në rastin e ujësjellësve jemi para një dileme, sepse nuk mund t'i lemë qytetarët pa ujë apo t'u ndërpresin aktivitetin, edhe pse shumë prej këtyre ujësjellësve u kemi bllokuar edhe llogaritë bankare. Më duhet t'ju theksoj që është një borxh i mbartur, i trashëguar ndër vite, pra nuk është një borxh që ka lindur këto 2-3 vjetët e fundit, nga ana e kompanive të ujësjellësit. Ka një përmirësim të situatës në disa ujësjellës, siç janë ujësjellësit e Tiranës, Fierit, Korçës dhe Elbasanit, në mos gaboj, të cilët nuk gjenerojnë më borxhe prej disa vitesh, duke paguar faturën korrente dhe kanë bërë aktmarrëveshje ku paguajnë edhe borxhin e vjetër.

Po ashtu, një problem është edhe Albpetroli, i cili në vitin 2020, për shkak të vështirësive që kishte për mosshitjen e naftës, sepse nuk kishte treg për shkak të situatës së Covid-it, krijoi një borxh prej 2 miliardë lekësh, por ka filluar prej 5 muajve, sepse kemi hyrë në aktmarrëveshje dhe kemi skeduluar borxhin, duke e likuiduar.

Është shumë e thjeshtë të flitet dhe të thuhet pse nuk ua keni prerë energjinë, por risku që do të kishim nga ndërprerja e energjisë të puseve të naftës dhe dëmin ekonomik mund ta llogarisni vetë. Pra, ne kemi qenë të detyruar në disa raste që të mos veprojmë, sepse e kemi menduar shumë më thellë këtë gjë. Është e kollajtë t'i lesh qytetarët pa ujë, por të gjithë e kanë parasysh se çfarë ndodhi para 9 vjetësh kur ish-kompania CEZ i ndërpreu furnizimin me energji elektrike nëpërmjet nënstacioneve pompave të ujësjellësit dhe se cili ishte reagimi. Është një pikë, ku ne vërtetë nuk kemi arritur ta realizojmë objektivin tonë, megjithatë qeveria ka nisur, këtë mund t'ju thotë edhe zoti Bejtja më qartë, një reformë me sh.a.-të e ujit në...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Klotilda Bushka** – Zoti Çela, mund të vazhdoni.

Ju lutem kolegë, a mund të dëgjojmë përgjigjet?

**Ardian Çela** – Në qoftë se më keni thirrur për më të dëgjuar, në rregull, sepse komente nuk kam bërë, thjesht po u përgjigjem pyetjeve.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do të flas edhe për Bitcoinin, pa merak.

**Klotilda Bushka** – Zoti Sula, ju lutem, është momenti që zoti Çela të japë përgjigje!

Zoti Çela, ju lutem, mund të vazhdoni me përgjigjet!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*



**Ardian Çela** – Unë nuk i bie përqark, pasi jam administratori i OSHEE Grup, nuk kam përgjegjësi...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sa i përket pyetjes si operon FTL-ja, më duhet t'ju them se Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Grup ka bërë *abounding*, sepse është reformë e monitoruar nga Sekretariati i Komitetit të Energjisë, si dhe nga institucione të tjera financiare ndërkombëtare, si Banka Botërore, KfW-ja dhe në këtë rast edhe BERZHI, i cili mundëson dhënien e këtij 70-miliardëshi.

Furnizuesi i tregut të lirë ka disa detyra. E para, të garantojë energjinë për shërbimin universal, ku furnizuesi i shërbimit universal është ai që garanton furnizimin me energji elektrike të të gjithë abonentëve me tarifë të rregulluar, pra në rastin e sotëm janë 1,2 milionë abonentë, familjarët dhe të gjitha bizneset, përveç atyre që kanë dalë në tregun e lirë.

Gjithashtu, ka si detyrë të garantojë furnizimin me energji elektrike për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, energji, të cilën e siguron nga HEC-et private dhe në rast se ato nuk e realizojnë, e plotëson nëpërmjet blerjes në tregun e lirë.

Këtu dua të bëj një sqarim, sepse ka një pavërtetësi shumë të madhe. Furnizuesi i Tregut të Lirë e blen energjinë në tregun e lirë në funksion të disa akteve ligjore që ka, sepse ka një vendim të Këshillit të Ministrave dhe të Entit Rregullator që e përcakton qartazi si duhet ta blejë dhe ta shesë energjinë elektrike.

Që nga viti 2017, Furnizuesi i Tregut të Lirë, pavarësisht se është krijuar më vonë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në atë kohë dhe tani Furnizuesi i Tregut të Lirë, ka implementuar platformën e ankandit, e cila është platforma më transparente që ekziston në Shqipëri deri në momenti që bursa do të jetë aktive. Për këtë janë vetë faktet që flasin, sepse para 8 vjetësh kanë qenë vetëm 3 kompani prezentë në treg, nuk është e nevojshme t'i nxjerr emrat, të cilat kontrollojnë rreth 95-97% të tregut dhe blerja e energjisë bëhej me zarf apo me takime në zyrë, me negociatë tek për tek. Ky është fakt dhe nuk është demagogji. Sot janë mbi 20 kompani të licencuara, të cilat nuk i licencen operatori, i licencen Enti Rregullator. Janë kompani shqiptare ose të huaja, që marrin pjesë në kohë reale dhe e shohin në kohë reale ofertën e tyre, sasitë që kanë ofruar dhe, ose janë eliminuar, ose janë kualifikuar. Furnizuesi i tregut të lirë nuk ka rol fare në këtë pikë, hap vetëm ankandin, jep profilet e ngarkesës orare: *base load* dhe *pick load*, që duhen, oraret e lëvrimit të ngarkesës dhe kaq, pastaj pjesëmarrja është automatike dhe vetë subjektet e shohin ku janë e ku nuk janë.

Ju thatë se Kosova dhe Maqedonia e Veriut shesin në bursë, Nuk kanë bursë ende Kosova dhe Maqedonia. Madje Kosova është integruar në ALAPEX, që është bursa e

Shqipërisë dhe Kosovës, që është në proces, sepse është shpallur dhe prokurimi i platformës me mbështetjen e USAID-it. Ju e dini që është OST-ja operatori, dhe nuk është OSHEE-ja. Ne nuk shesim dhe nuk blejmë në bursë sot dhe as më parë askush nuk ka blerë e ka shitur në bursë. Arsyet janë juridike dhe financiare. Unë do të jap dy, për të mos u zgjatur:

Së pari, ka bursa, siç ka bursa ne Serbi, Kroaci, Hungari, Greqi, Itali, por në rajon, përveç Serbisë, nuk ka bursë të ngritur. Është në proces në Maqedoni dhe në Mal të zi. Që të jesh anëtar i bursës duhet të zbatosh disa kritere ligjore, jo vetëm që duhet të jesh i regjistruar, por të kesh edhe aktivitetin, si në Hungari, për shembull.

Së dyti, problemi tjetër është *cash flow* i disponueshëm. Për shembull, u përmend historia e importit në shtator, me të drejtë, sepse vlerat e importit kanë qenë të konsiderueshme dhe vazhdojnë të jenë, por në rast se në muajt shtator kemi importuar 44 milionë euro energji, ne duhet të kishim 44 milionë euro garanci fond, dhe *day after* duhet të paguanim 44 milionë të tjera, sepse janë rregullat e bursës në UPEX. Pra, për muajt shtator duhet të kishim 88 milionë euro *cash flow* garanci. Kompania nuk e ka dhe nuk kemi thënë asnjëherë që e kemi këtë lloj *cash flow*, sepse nuk kemi notuar në miliona. Brenda vitit 2022 ALPEX –i do të jetë aktiv dhe kjo do të na japë frymëmarrje. Megjithatë jo detyrimisht, ky është mendimi im personal, tregu i lirë dhe bursa është çmimi më i lirë. Këtu duhet të jemi të sinqertë, sepse, nëse është kështu të gjitha këto vende që kanë bursë duhej ta kishin çmimin më të lirë, por nuk e kanë.

**Ilir Bejtja** - Pyetja tjetër ishte: OSHEE-ja blen energji nga KESH-i?

**Adrian Çela** - Nuk ndodh, sepse...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Në momentin që KESH-i shet, shet surpluset. Pra, funksionon kështu: çdo fundjavë ose çdo fundmuaji, furnizuesi i tregut të lirë merr nga FSHU-ja dhe OSSH-ja nevojat që kanë për muajt pasardhës ose javën pasardhëse. Këto janë llogaritje që dalin nga llogaritjet shumëvjeçare dhe mesatare që ne kemi. KESH-i kthen përgjigjen nëse i plotëson ose jo këto nevoja. Nëse KESH-i nuk i plotëson nevojat, për diferencën FTL-ja del dhe e blen në treg të lirë. Në rast se KESH-i i plotëson këto nevoja, këtu mbyllet ky kapitull, as FTL-ja nuk del më në shitje dhe KESH-i nuk mund të shesë më në treg të lirë nëse nuk plotëson nevojat e FSHU-së. Sa herë KESH-i ka dalë në shitje, kanë qenë surplus, ku KESH-i i ka plotësuar nevojat e FTL-së, sepse detyra e gjeneruesit publik është: i shet pluset që ka pasi plotëson nevojat e shërbimit universal. Kjo është e padiskutueshme dhe kjo është kollaj fare e verifikueshme.

**Ilir Bejtja** - Pyetja e fundit për barazinë ndërmjet buxhetorëve dhe privatëve para ligjit atë e shpjegoi.

**Adrian Çela**- Besoj se pyetjes së borxhit për ujësjellësit ia dhamë shifrën.

Për rastin e Bitcoin-it unë do t'ju jap këtë informacion. Ne kemi nisur fazën e parë të investimit, sepse ky shqetësim nuk ka qenë vetëm me bitcoin, por edhe më herët me shtëpitë e barit, serrat e barit. Jo vetëm për këtë fakt, ne kemi nisur edhe për monitorimin e humbjeve të vetë kompanisë monitorimin e 1200 fidrave që ka kompania 1200 *smart meter* që janë montuar. Tani jemi në fazën e dytë, *balanc metering* quhet, në vendosjen e *smart metering* në rreth 26 mijë kabinat që ka kompania, sepse një fider është me kilometra i gjatë dhe ka edhe 70-100 kabina. Nuk është e thjeshtë për t'u kapur.

Duke kaluar në fazën e dytë, te monitorimi i kabinave, ne fillojmë e ngushtojmë rrethin e kërkimit. Sot që flasim ne kemi evidentuar dy “ferma” Bitcoin, dhe i kemi denoncuar, njëra në Tiranë dhe tjetra në Fushë- Krujë. Kemi marrë masa edhe ndaj ekipeve që monitoronin atë zonë, jo vetëm me largim nga puna, por i kemi çuar edhe për ndjekje penale.

Sigurisht, është një proces dhe një betejë e përditshme që kemi dhe jo vetëm me Bitcoin-in, jo vetëm me kultivuesit e bimëve narkotike, por me cilindo që vjedh energjinë. Kjo është një betejë e përditshme, siç eidentojmë lidhje të paligjshme në biznes e të tjera, edhe ky është një proces që ne e kemi në qendër të vëmendjes. Me investimin tjetër, që unë thashë që është në proces dhe në suportin e bankës amerikane të eksport importit për ta suportuar këtë lloj investimi dhe USAID-it, pa diskutim rezultat do të jenë më të mira, por jo çdo gjë bëhet me krahë, kërkon edhe investime *smart*, të cilat jemi duke i realizuar.

**Ilir Bejtja** – Një mendim shtesë për Bitcoin, ai është aktivitet i palicencuar, kjo nuk do të thotë që nuk na ka paguar energji. Ne identifikojmë vetëm vjedhjen e energjisë, por denoncimi ka qenë edhe ndihmë për organet kompetente, për një aktivitet, që nuk është i licencuar.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ne kemi identifikuar ata që janë vjedhës të energjisë dhe kanë rezultuar midis këtyre me Bitcoin, por në raste të tjera, nëse e paguajnë energjinë, për ne janë konsumatorë dhe e paguajnë. Dallohen vetëm nga konsumi eksziv, që të mund t'i identifikosh, por ne nuk e kemi këtë funksion, pra të dimë se kush dhe pse harxhon më shumë energji. Në rast se ka denatyrim, patjetër që bëjmë denoncim.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

Në lidhje me pyetjen e zoti Bardhi, sa ka paguar buxheti i shtetit nga borxhi i OSHEE-së? Asnjë lek. OSHEE-ja e ka filluar këtë histori që nga viti 2013 me një borxh të prapambetur të KESH-it në momentin që u privatizua Operatori i Shpërndarjes rreth 10,8 miliardë lekë. E shlyen atë sipas një marrëveshjeje të bërë me Ministrinë e Financave dhe me KESH-in rreth

538 milionë lekë në vit. Është i skedulluar dhe nuk kemi asnjë vonesë ndaj tij dhe janë paguar të gjitha borxhet e prapambetura që kem i pasur ndaj palëve të treta jo banka, sepse nuk kemi pasur ndaj bankave. Kjo është kredia e dytë që OSHEE-ja merr nga viti 2014 deri tani. Kredia e parë ka qenë e Bankës Botërore, që ishte kredi sektoriale, pjesë e së cilës ishte edhe OSHEE-ja, që nuk i shfrytëzoi të gjithën për arsye të ndryshme: shpronësime e standarde, që ishin krijuar që nga viti 2012, nuk ishin më standardet tona. Për shembull, në kredi kanë qenë të parashikuar 290 mijë matës, me induksion, që ne nuk i përdorim më ato, nuk u realizua. Matësit e bilancit po kështu ishin të një standardi, që sot nuk përdoren në rrjetet e shpërndarjes në rajon dhe në BE, ndaj nuk u realizuan dhe nuk kemi ndonjë kompleancë nga ana e bankës për këto mosrealizime. Janë konsideruar si mosrealizime objektive, pra rreth 63 milionë euro investim u realizuan rreth 32.

Për këtë arsye, ne sot po bëjmë edhe nënstacionin e qendrës, që ka qenë pjesë e kredisë së Bankës Botërore, pra po e bëjmë tani me këtë kredi.

Dëmet e evidentuara nga auditi

Nuk kemi asnjë. Është audituar dhe auditohet edhe nga ekspertë vendas dhe nga *Big Four* dhe të vetmet raste, për të cilat ne kemi marrë auditimin me rezervë, ka qenë inventarizimi i aseteve dhe borxhi midis postave dhe kompanisë OSHEE. Të tjerat në këtë moment janë të ezauruara dhe mbetet vetëm ndarja e aseteve midis ndërmarrjeve bija të krijuara në vitin 2020.

Pyetja tjetër është për tenderët.

**Adrian Çela** – Atëherë, Operatori Shpërndarës i Energjisë Elektrike është një kompani publike, kështu që, për sa u përket prokurimeve i nënshtrohet ligjit “Për prokurimet publike”

Në prokurimet publike të OSHEE-së marrin pjesë të gjitha kompanitë që plotësojnë kriteret ligjore dhe kriteret teknike.

Nuk di të them sa është numri, por ka një gjë, për sa kohë ne prokurojmë nëpërmjet platformës së Autoritetit të Prokurimeve Publike, janë të gjithë të publikuara, janë të gjitha publike dhe transparente.

Për sa u përket fondeve, sa është përqindja e fondit, unë di të them që, përpara se të bëhet një investim, bëhet projekti dhe fondi limit.

Për nxjerrjen e fondit limit ka një manual çmimesh, të cilave ne u referohemi. Unë, personalisht, nuk jam as partizan i atyre gjërave që kam dëgjuar jo po 30%, jo po 5%, jo po 40%. Çdo mall ka një vlerë të caktuar në treg. Kablloja e bakrit ka një vlerë të caktuar, kablloja e aluminit ka një vlerë të caktuar, transformatori ka një vlerë të caktuar, gjeneratori, çelat, panelet e të tjerat, kanë një vlerë të caktuar dhe nuk mund të ndodhë që unë të kërkoj të blej një makinë me 10 lekë, kur makina nuk kushton 10 lekë.

Prandaj po them se ne kemi qenë transparentë. Ne auditohemi dy herë në vit, si nga KLSH-ja, për auditim financiar dhe prokurime, ashtu edhe nga *Big Four*, që mund të jetë *Deloitte Touche*, KfW apo kush ta fitojë. Pra, në asnjë nga këto raste nuk është gjetur dëm ekonomik. Mund të jenë gjetur problematika dhe nuk them jo, se kush punon përditë edhe krijon probleme, por dëm ekonomik në asnjë rast nuk ka pasur.

Gjithsesi, ato janë transparente dhe ju mund t'i shkoni te faqja e Autoritetit të Prokurimeve Publike.

**Ilir Bejtja** – E kemi bërë ne si kontroll se sa kompani janë. Janë disa dhjetëra ndër vite, të mos them qindra. Varet nga tipologjia, sepse jo të gjitha paraqiten në çdo tender që ne kemi. Kur bëhet fjalë për punime civile, ka për punimet civile, kur bëhet fjalë për konstruksione metalike, traversa, shtylla, ka të tjera, dhe, kur bëhet fjalë për nënstacione, rrjeta, shtrime kabllosh, rregullime filtrash dhe kabinash, ka të tjera. Pra, janë sipas kategorive të drejtuesve teknikë që ata kanë në stafin e tyre

Për Shkodrën, ka transparencë dhe çdo qytetar mund të hapë faqen e OSHEE-së dhe të bijave dhe të lexojë çdo gjë atje. Bilanci është i gjithi i paraqitur atje, të gjitha operacionet ekonomike janë të gjitha të paraqitura atje në anglisht dhe në shqip.

E kemi detyrim këtë, të vendosur nga Banka Botërore që në vitin 2017. Më përpara kemi pas nxjerrë disa tregues që na detyrojnë te FMN-ja, që lidheshin me treguesit e borxhit, mjetet e veta, mjetet e huajtura, pjesa e aseteve dhe të gjitha me radhë. Tani e nxjerrim bilancin, kemi edhe programin ekonomik afatshkurtër dhe afatgjatë. Deri tani kemi aplikuar deri në 5 vjet për programin afatgjatë. Jemi duke hartuar me bijat edhe strategjitë 15-vjeçare që do t'i paraqesim shumë shpejt në kuadrin e reformës.

Mungesë energjie në Shkodër...

**Adrian Çela** – Ju thatë se në Shkodër nuk janë bërë investime. Në Shkodër janë investuar 2,5 miliardë lekë të rinj, 110 mijë km kabllo elektrik, nga viti 2016 e këndej.

Në vitin 2018 ne kemi futur në punën nënstacionin e Bushatit, i cili ishte ndërtuar me fondet e KfW-së në vitin 2011, në mos gaboj, dhe ishte 8 vjet pa punë, sepse nuk kishte bërë asnjë fidër. Është fakt sot që nënstacioni i Bushatit funksionon me investimet që kemi bërë në disa fidra. Këtu është edhe ish-drejtori që ka qenë për një periudhë dhe mund ta konfirmojë.

Kemi investuar në Velipojë dhe jemi në proces për nënstacionin e ri të Velipojës. Është investuar linja e re 35 kilovolt. Sa herë vinte stina e verës në Velipojë, të gjitha hotelet i kapte tmerri, se nuk garantonin dot furnizimin me energji elektrike. Në qoftë se Velipoja dhe Shkodra kanë pasur një sezon të mirë turistik në verën e fundit, një meritë i takon OSHEE-së që u ka garantuar furnizimin me energji elektrike operatorëve turistikë.

Në qoftë se doni, unë mund t'i përmend investimet që kemi bërë në Shkodër, ku kemi zëvendësuar 6 fidra të rinj, të cilët i kemi kaluar në 20 kilovolt, sepse ishin me 6 kilovolt prej 40 vjetësh. Kemi në Bahçallëk. Janë në investim tani zona e Trushit, Ura e Kirit, kemi Tamarën dhe shumë të tjera. Investimet e Shkodrës nuk mbarojnë këtu.

Për herë të parë, në sajë të këtyre investimeve dhe rritjes së kontrollit dhe efikasitetit në drejtorinë e Shkodrës, vetëm në muajin shtator për herë të parë Drejtoria Rajonale e Shkodrës i uli humbjet në nivelin 25%. Ishte diçka që nuk imagjinohej as para 4 vjetësh. 50% ishin humbjet, sepse ishin humbjet teknike tmerrësisht të larta që mundësonin edhe humbjet joteknike.

A kemi staf joprofesionist? Edhe mund të kemi, nuk e mohoj. Ky është një proces ku ne jemi në betejë të përditshme. Ne kemi instaluar në kompani treguesit e performancës.

Ka një fakt që dua ta vlerësoj. Numri i ankesave për keqfaturim (ky është tregues), në qoftë se e shohim ndër vite (unë do t'ju jap shifra dhe nuk do të bëj krahasime me vitin 2013, se ne si komani e kemi bërë krahasimin me vitin paraardhës), në vitin 2017 ne e kishim numrin e ankesave për keqfaturim, që bëhet nga lexuesit, diku te 60-mijëshi, në vitin pasardhës 40 mijë dhe këtë 8-mujor jemi 25 mijë.

Pra, unë nuk them që është zhdukur, sepse keqleximi, rreth 70-80% e ankesave janë në të drejtë të abonentit. Po flasim për një numër prej rreth 40 milionë faturash në vit, 1,2 milionë fatura në muaj. Objektivi ynë është ta çojmë zero dhe këtë keqlexim e bëjnë ato lexues që janë joprofesionistë dhe atyre lexueseve në çdo fundmuaji u monitorojmë keqfaturimin dhe ata largohen nga puna. Pra, ky është një proces. Ne nuk themi që jemi perfektë, nuk themi që kemi arritur idealen, por jemi në një proces të përmirësimit të përditshëm. Ju duhet të jeni dëshmitarë që shërbimi, kujdesi ndaj klientit, ankesat, aplikimet kanë një përmirësim tej mase të dukshëm.

Sipas *Doing Business*, kompania ka përmirësuar mbi 70 vende te “*getting electricity*”. Ishte 180 ditë. Janë të dhënat e *Doing Business* të Bankës Botërore, jo të miat. 150 ditë ishte aplikimi i biznesit për të marrë energji. 49 ditë ka zbritur. Kishim 44 sportele, sot kemi 98 sportele. Një sportel u shërbente 1600 abonentëve, ndërsa sot u shërben 600 abonentëve, pa përmendur këtu kanalet alternativë që çdo njeri mund të shkojë dhe nuk ka nevojë të rrijë në radhë te sportelet e kompanisë apo te posta, por shkon edhe me telefon apo te *Western Union* dhe bën pagesën.

Pra, këto janë përmirësime që ne u kemi ofruar qytetarëve. Nuk kemi arritur perfekten, por jemi në proces. Ky është një proces që nuk mbaron kurrë. Jemi drejt investimeve *smart* dhe investimet *smart* kanë edhe matjen inteligjente, edhe ndërveprimin inteligjent ndërmjet kabinave dhe nënstacioneve.

**Ilir Bejtja** – Mund të vazhdojmë me pyetjet e zoti Gogu, apo keni diçka tjetër?

Dakord.

Cilët janë dy faktorët kryesorë? Janë mori dhe COVID-i. Moti është diçka që ka qenë qysh kur janë ndërtuar veprat tona hidrike, të cilat janë ato që mbajnë peshën kryesore të prodhimit në vend, mbi 80% (flas për kaskadën e Drinit). Sezonaliteti që ne kemi, uniciteti që kemi me vendet e Ballkanit Perëndimor, pra kur kemi ne ujë, kanë të gjithë dhe nuk është se mund të bësh këmbime me vlerë në vende, të cilat prodhojnë po me të njëjtat burime dhe ky disproporcion që kemi për shkak të motit na bën të kemi prodhim gjatë 3-4 muajve, shkurt deri qershor, më pas të fillojmë të blejmë energji.

Unë do t'ju marr shembullin e vitit 2020, ku kemi kombinuar në mënyrë perfekte, brenda mundësive që kemi mbi bazën e njohurive *know how*, një situatë ku KESH-i prodhoi vetëm 2,8 terravat të energjisë. S'ka ndodhur ndonjëherë. Prodhimi është shumë i ulët, vetëm në vitin 1974 ka ndodhur një i tillë. Deri në fund të vitit arritëm të balancojmë midis importeve, atëherë kur nuk kishim ujë, duke e konsruar ujin për një prodhim të pranueshëm deri në fund të muajit gusht. Kjo na bëri ta kalojmë vitin 2020 jo me ndonjë krizë të tmerrshme që duhej të ishte krizë e tmerrshme. Mjafton t'ju bëj diferencën: 1,2 terravat shumëzohet me rreth 50 euro më tepër, që është energjia që blejmë në import, bëjnë 60 milionë euro, që nuk u furnizua...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Klotilda Bushka** – Faleminderit!

E mirëkuptojmë, se është edhe komisioni tjetër duke pritur.

Po jap një njoftim. Komisioni i Ekonomisë është duke pritur.

Zoti Çela, jeni i lirë që pas përgjigjeve të shkoni atje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Krahasimin e arkëtimeve në vitin 2014 dhe krahasimin e humbjeve me 4-mujorin e vitit 2017.

**Adrian Çela** – Niveli i humbjeve 45%, sot jemi 20,9%. Niveli i arkëtimeve në vitin 2013 është 44 miliardë, sot jemi në nivelin 6,9 miliardë lekë të rinj ose në nivelin 97%-98%.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Çela!

Zoti Bejtja, mund të vijoni.

**Ilir Bejtja** – Vazhdoj me pyetjen e zotit Gogu. Sqarimi është ky që disproporcioni që kemi për sezonalitet, na çon në vështirësi çdo vit, në vitet e thata më tepër. Ajo që po përballojmë këtë vit, lidhet edhe me faktin e rritjes së tërbuar të çmimeve të importit. Ju keni të gjithë celular dhe keni akses, Bursa më e lirë e Energjisë në Europë nga e cila marrin dhe tregtarët tanë energji, dje është mbyllur me 248 euro, që është e çmëndur si situatë. Ne

mendojmë që kjo situatë mund të marrë një qëndrueshmëri dhe do të dimë se cilat do të jenë luhatjet, jo më herët se gushti i vitit që vjen. Ky është edhe parashikimi i Komunitetit Europian të Energjisë. Kriza ka ndodhur për shkak të dekarbonizimit dhe mbylljes së centraleve atomike.

Nëse më lejoni, unë do t'ju thosha vetëm një informacion shumë të shkurtër (një minutë, jo më tepër): energjia dhe lëndët ndihmëse për ata që janë ekonomistë zënë në përgjithësi jo më shumë se 3-4 % të kostove në total në çdo biznes. Është forcë motore, prandaj edhe produkti publik është siguria e furnizimit. Si kosto, në çdo biznes nuk rëndon më shumë se 3 lekë në 100. Ky është rasti i metalurgjive me induksion, Kurumi që e shkrin metalin me korrent, me elektroda grafiti. Pra, nuk është peshë e rëndë me kosto për biznese. A peshon shumë për familjarët? 213 familje subvencionohen për 300 kilovatë. Nëse jetoni me pak kujdes, nuk ju duhen 300 kilovatë energji në shtëpi gjatë muajit. Pjesa tjetër janë një grup prej rreth 70 mijë familjesh, që nuk janë pjesë e grupeve vulnerabël, që deri në pikën 389 kilovatë, pra pritet çmimi, humbin lekë, humbin shumë pak nga fatura e tyre. Në lekë të rinj bëhet fjalë nga 200-300 lekë të rinj në muaj. Kush konsumon mbi 389 kilovatë në muaj, vetëm kursejnë nga sistemi me një tarifë. Nuk kanë më atë tarifën e famshme 13,5 lekë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Harxhoni sa lekë të keni. Ata që nuk kanë, janë të subvencionuar. Po kursyet, na ndihmoni, sepse nuk blejmë.

Zoti Gogu, për humbjet e morët përgjigjen.

**Ilir Bejtja** – Investimet i kemi të limituara deri në vitin 2023. Me planin e ri të konsolidimit financiar duhet të bëjmë 270 milionë euro investime. Nuk kemi pasur mundësi t'i bëjmë.

Sa është rezultati financiar i 6-mujorit të parë? 6-mujori i parë është me rezultat pozitiv, nuk di t'ua them shifrën, por aq i mirë sa të zbusë çmendurinë e këtyre 4 muajve.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Do ta zbusë, sa të munda, por çmimet janë shumë të tërbuara.

Si e vlerëson BERZH-i situatën në OSHEE? Kritike, por jo si situatë menaxhimi biznesi, por për shkak të pasigurisë që kemi për ta siguruar energjinë. Nuk ka energji në treg.

Vetëm në vitin 2020 kemi humbje me 2,7 miliardë lekë. Vitet e tjera kanë qenë mbi 6 miliardë fitim çdo vit. Presim një humbje prej rreth 10 miliardë lekësh. Në fund të këtij viti presim rreth 10 miliardë lekë humbje.

Zonja Xhixho, krizën me menaxhimin jeni vetëm ju që e keni konstatuar, asnjë ekspert, ndryshe nuk e di, por mund të na përmendësh ekspertët. Dyshoj shumë madje (e kam pas edhe



koleg) në ekspertizën e tij. Ekspertët janë të certifikuar, të licencuar. Ekspertë të certifikuar kemi agjencitë e auditimit, bankat partnere, jemi të monitoruar me ligj. Jemi të monitoruar nga BERZH-i për shkak të rifinancimit të borxhit të KESH-it. Kush mund të dëshirojë, mund ta shikojë, është aneksi C, që është kusht për financimin e borxhit. I referohet vetëm OSHEE-së. Aty janë të gjitha standardet financiare, të cilat ne jemi të detyruar t'i zbatojmë.

Po ju them 2-3 elemente shumë të rëndësishme: që ne të marrim rifinancimin e borxhit të vjetër të trashëguar në OSHEE-ja nga KESH-i, është dashur të ruajmë disa leva financiare. Një nga këto fillonte që nga viti 2016, fillonte me 8 herë ebidian borxhi. Ne qëkur e kemi filluar, e kemi filluar me 1,6 ebidian. Pra, borxhi i ndërmarrjeve është administruar edhe për meritën tonë, por edhe për meritën e partnerëve tanë. Ka një plan, një vendim qeverie me nr. 742, datë 12.12.2018, ku KfW-ja bashkë me Ministrinë e Financave dhe atë të Energjisë kanë përcaktuar një plan strategjik të masave për reformimin e sektorit publik, i cili nuk e ka lënë më sektorin në rrjedhje të lirë, por brenda 2 vjetëve janë zbatuar 18 elementet e këtij plani *road map*, i quajtur ndryshe nga ana e partnerëve, për reformimin e sektorit. Na kanë mbetur vetëm miratimi i kontratës për diferencën, e cila lidhet me bursën dhe me hapjen e tregut, krijimi i operatorit të energjive të rinovueshme, i cili si funksion sot, me vendimin 275 të qeverisë përkohësisht, kryhet nga FTL-ja dhe kemi për të riparë vendimin e mbështetjes së konsumatorëve vulnerabël, i cili do të parashikojë mbrojtjen nëse liberalizohet tregu i tensionit i ulët që nuk e kemi në plan të afërt. Kjo na jep mundësi të marrim eksperiencat më të mira për të parashikuar nëse duhet të shtojmë apo të pakësojmë elemente të mbrojtjes.

U tha këtu një konstatim: 38 mijë qytetarë në burg. Zonjë, kjo vlen vetëm për Kinën. Gjithsej ne kemi kallëzuar penalisht 2100 veta, midis tyre 700 janë punonjësit tanë. 48 orë burg mund të kenë bërë, t'ju bëj qefin, 10 veta. Këta kanë qenë vjedhës, ndërhyrës të paligjshëm në rrjetin e energjisë elektrike.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Zoti Bardhi, keni qenë ministër i Drejtësisë, mund t'i referoheni periudhës suaj dhe mund t'i nxirrni. Të dhënat zyrtare janë këto që po ju them unë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Klotilda Bushka** – Zoti Bejtja, vazhdoni me përgjigjet!

**Ilir Bejtja** – Ja soli mendja e tij, se për 35 mijë lekë të vjetër nuk varet njeri.

Dashi është dhe jurist. Nëse e mban mend nga koha që ke qenë prokuror, që një njeri është varur nga një borxh prej 35 mijë lekë të vjetra...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, zonjë, nuk po tallem!

**Klotilda Bushka** – Ju lutem kolegë, mos bëni rrëmuje në komision!

**Iir Bejtja** – Zoti Bardhi, unë kam vetëm një parim që këto janë të vërteta, se nuk dua të lodhem të mbaj mend çfarë kam thënë herën e fundit.

*(Debat pa mikrofon)*

Shkoni e shikojeni. Nuk tërheq asnjë gjë unë.

*(Debat pa mikrofon)*

Ai ka qenë në burg për tridhjetë e pesë mijë lekë.

Nuk tërheq asgjë nga kjo.

*(Debat pa mikrofon)*

Jo, jo, nuk kam fyer askënd.

*(Debat pa mikrofon)*

Unë kam qenë politikan si ju, dhe di ta përdor shumë mirë fjalën.

**Klotilda Bushka** – Zoti Bejtja, do të vazhdoni përgjigjen?

*(Debat pa mikrofon)*

Kolegë!

**Iir Bejtja** – Tridhjetë e pesë lekë të vjetra.

*(Debat pa mikrofon)*

Jo, more vëlla, nuk ka vuajtur burg për atë.

**Klotilda Bushka** – A ka mundësi të mbajmë një radhë në marrjen e fjalës?

*(Debat pa mikrofon)*

Ju lutem!

Zotërinj, do ta ndërpres diskutimin dhe do të kalojmë në votim, në qoftë se nuk mbani qetësi!

*(Debat pa mikrofon)*

**Iir Bejtja** – Jo, nuk ka lidhje me borxhin.

*(Debat pa mikrofon)*

**Klotilda Bushka** – A ka mundësi të më dëgjoni, ju lutem!

*(Debat pa mikrofon)*

Unë e ndërpres diskutimin dhe kalojmë në votim.

*(Debat pa mikrofon)*

Zoti Bejtja!

*(Debat pa mikrofon)*

Zoti Bejtja, nuk jeni duke u dëgjuar.

*(Debat pa mikrofon)*

Një minutë!

*(Debat pa mikrofon)*

Zoti Bardhi, ju lutem, nuk jeni duke u dëgjuar.

*(Debat pa mikrofon)*

Zoti Bardhi, e kam marrë fjalën unë! Të lutem!

Zoti Bejtja, të lutem!

A mund të pushoni pak të gjithë? Ju lutem!

*(Debat pa mikrofon)*

Ju lutem! Ju lutem!

*(Debat pa mikrofon)*

Zoti Bejtja, ju lutem mos e vazhdoni diskutimin!

*(Debat pa mikrofon)*

Zoti Bejtja, a mund të pushoni një sekondë, ju lutem? Mbylleni pak mikrofonin, zoti Bejtja!

*(Debat pa mikrofon)*

Zoti Bejtja, mbylleni pak mikrofonin!

*(Debat pa mikrofon)*

Kolegë, ju lutem! Nuk kemi pse ngremë zërin. Mund të komunikojmë me njëri-tjetrin me qetësi.

Atëherë, zoti Bejtja, merrni fjalën tani. Ju lutem vazhdojeni atë që thatë më parë dhe mbaroni të gjitha përgjigjet.

*(Debat pa mikrofon)*

Zoti Bejtja sapo kërkoi ndjesë.

Ju lutem, zoti Bejtja vazhdoni me kthimin e përgjigjeve! Kujdes me gjuhën që përdorim në këtë komision. Dakord? Ju lutem, të gjithë kemi të njëjtat parime në lidhje me diskutimet që bëjmë.

*(Debat pa mikrofon)*

Do ta ndërpres mbledhjen, në qoftë se nuk silleni siç duhet.

*(Debat pa mikrofon)*

Në rregull! Pesë minuta pushim!

*(Debat pa mikrofon)*

Kam ndërprerë mbledhjen. Pesë minuta pushim.

*(Debat pa mikrofon)*

Vazhdojmë? Uluni!

*(Ndërpritet mbledhja)*

Vazhdojmë mbledhjen e komisionit, të cilën e ndërpreme për shkak të një situatë të krijuar këtu.

Në fakt, fillimisht, përpara se të vijojmë mbledhjen, do më duhet t'ua tërheq vëmendjen përfaqësuesve të ministrisë për gjuhën e përdorur këtu, por edhe kolegëve tanë u kërkoj që në sqarimin e rrethanave, edhe ne të ruajmë qetësinë, sepse nuk kemi pse e ngremë zërin më shumë se ç'është, kur mund të merremi vesh më me qetësi për të njëjtat çështje.

Kështu që, do ta vijojmë mbledhjen e komisionit. Në këtë pikë, do të vazhdojmë me zotin Sevrani, përfaqësuesin e OSHEE-së, dhe sigurisht do të analizojmë edhe këtë që ndodhi në vijim.

Ju lutem, kolegë, tani për diskutime, dhe unë do ta kaloj marrëveshjen në votim.

Zoti Korreshi ka kërkuar fjalën.

**Saimir Korreshi** – Po, për diskutim. Faleminderit, kryetare!

Atëherë, nuk pranoj për diskutim vetëm diçka, se këtu na u tha nga drejtori i OSHEE-së, që OSHEE-ja paska rritje në performancë; paska vënë buzëkuq, por paska tre javë pa u larë. Tani, le të flasim realitetin: gjendja në terren është katastrofë në të gjithë fshatrat, me atë që unë di, të paktën, gjë që e them me përgjegjësi të plotë. Në të gjithë fshatrat e Lushnjës, edhe në rrethinat e qytetit, por në të gjithë fshatrat e Lushnjës, një vesë shi bie dhe nuk kanë drita. Një vesë shi dhe ua ndërpresin, sepse rrjeti është tejet i amortizuar. Jo rrallëherë, njerëzit më shkruajnë për dritat, sepse kanë me nga tetë apo nëntë orë pa drita në Lushnjë.

Së dyti, të gjithë drejtuesit, punëtorët dhe të gjithë çfarë ka OSHEE-ja në brenda Lushnjës, të gjithë i ka punëtorë partie, të gjithë janë me tesera partie dhe ky është edhe më shumë skandal që e zhyt më keq OSHEE-në në çfarë po ndodh. I kanë hequr njerëzit nga OSHEE-ja e Lushnjës, me pretekstin se kanë djegur flamurin e PS-së apo për gjëra të tjera dhe sot njerëz që kishin nga 23 apo 24 vjet në OSHEE kanë 8 vjet pa punë, ose i kanë degdisur inxhinierë nëpër qytete të tjera. Kjo e ka ulur performancën përtej këtij fakti. Po të shikosh zyrën e shërbimit në Lushnjë, hajdeni gjeni ndonjë elektrikist atje. Nuk ka dhe, kur merr në telefon, shkon policia, sepse nuk ka makinë për ta çuar OSHEE-në nëpër vende. Marrin në telefon dhe shkojnë me makinën e policisë për të rregulluar defektin. Është turpshme që t'i çojë policia elektrikistët për të rregulluar defektin; është e turpshme!

Së fundi, meqenëse do t'i kthehem edhe një herë atij zëvendësministrit, por...

*(Debate pa mikrofon.)*

Mos më ndërprit fare, zonjë! Çfarë budallëku?! Budallaqet janë tuajat, që po rruani lekët atje e vini këtu na tregoni performancën e madhe të OSHEE-së.

**Klotilda Bushka** – Ju lutem, zoti Korreshi, mbarojeni fjalën!

**Saimir Korreshi** – Do të mbaroj dhe do t'i kthehem, sepse ai qytetari atje, që ka vdekur, është një qytetar i nderuar dhe nuk ka vdekur se ka vuajtur nga trutë e kokës, as nga depresioni, por nga turpi. Është nga turpi, për 35 mijë lekë të vjetër. Situata atje është jashtëzakonisht e rëndë, sepse nuk kishte vjedhur as energji elektrike, por vetëm se ai, që këta e quanin dyqan, kishte një sahat si për shtëpinë, ehe për dyqanin poshtë dhe nuk bënë dot diferencimin e taksimit midis borxhit, që mund të kishte si energji për biznes dhe shtëpisë. Kur bënë kalkulimin, i dolën 35 mijë lekë të vjetër. Po nuk është turp të rrijë në burg, të harrohet në burg një njeri dhe të vish sot e të thuash se ka ikur nga mend e kokës?! Unë nuk mund ta pranoj për një qytetar lushnjar, nuk mund ta pranoj, sepse ka qenë nga fis i nderuar dhe fisnik burrë. Kështu që turp ta ketë ai që e tha, sepse e kam pasur kolegë dhe mendoj se ishte burrë i mirë deri më sot, por nuk e paskam njohur! Paska qenë... Nuk di ç'a të them. Ndaj elektrikun, OSHEE-ja e keni për faqe të zezë. Ka një shprehje andej nga Lushnja, por është pak banale dhe nuk do ta them: njeri vërshëllen andej nga Leçia dhe ikin dritat në Lushnjë.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Zoti Kollçaku, fjala për ju.

**Bardhyl Kollçaku** – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, jam dakord me marrëveshjen.

Në fakt, janë dy marrëveshje: marrëveshja e garancisë dhe marrëveshja e huas. Marrëveshja e garancisë është që qeveria shqiptare del garant për huan që do të marrë OSHEE-ja. Kjo, sipas relatorit, është marrëveshja e dytë në këto vitet e fundit. Ne duhet të pranojmë dy gjëra që janë fakte.

Së pari, garantimi me energji elektrike ka ardhur duke u rritur, me përjashtim të atij shqetësimi që në shumë fshatra ende investimi nuk është përkthyer me shërbime për qytetarët dhe në ulje të humbjeve në rrjet. Unë këtu e kam merakun e madh, pra që marrëveshja do të merret më shumë për *cash flow* se sa për investime, sepse ne e dimë që investimi ka dy përfitime: garantim të sigurt me energji elektrike për konsumatorin e biznesin dhe ulje të humbjeve në rrjet. Unë shpresoj që pavarësisht nga dy krizat që ne jemi duke kaluar, pra krizën energjetike të thatësirës që ka qenë për rajonin, dhe ne varemi kryesisht nga shirat për furnizimin me energji elektrike, dhe COVID-in, shumë shpejt do të dalim nga kjo gjendje e rënduar dhe do të rrisim performancën e humbjeve në rrjet, por edhe të garantimit të furnizimit. Jam shumë dakord që sa më shpejt të jetë e mundur të dalim nga kjo situatë, sepse vërtet kjo është një masë garancie dhe jam i sigurt se BERZH-i është në këtë marrëveshje dhe kushtet janë të favorshme që ta miratojmë, por i bëj thirrje OSHEE-së që të shikojë edhe një herë planin

e investimeve. Unë e pashë shumë që është vendosur, por jam për atë që të rritet performanca dhe të ulen humbjet se sa të heqim dorë nga investimet. Investimet janë shumë të rëndësishme qoftë për garantimin e konsumatorëve, sidomos për furnizim të pandërprerë në fshatra, por edhe për uljen e humbjeve.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Zoti Mediu.

**Fatmir Mediu** – Faleminderit, zonja kryetare!

E dëgjova me vëmendje drejtorin dhe zëvendësministrin. Së pari, dua të them se është mirë që ne si deputetë të kemi më shumë vlerësim dhe respekt për njëri-tjetrin, pastaj të shikojmë se si duhet të ndërtojmë një raport me ata që vijnë për të raportuar me këtë komision. Rregulli etik është që, së pari, ata që vijnë për t'u dëgjuar apo për të dhënë vlerësime në komisione, duhet të dinë se ku vijnë. Prandaj është detyra juaj, por edhe të gjithëve ne si deputetë që të ndërtojmë një raport të drejtë me çdo përfaqësues të qeverisë. Ne jemi parlament dhe parlamenti është institucioni bazë, sepse qeveria varet nga parlamenti, nuk është parlamenti që varet nga qeveria.

Më pas po shkoj te çështja konkrete. Unë ngrita disa pyetje: borxhi që kanë entet publike në institucionet shtetërore arrin në rreth 200 milionë dollarë. Me kamatë shkon edhe më shumë. Prandaj, kjo është një çështje që patjetër kërkon zgjidhje dhe janë një zinxhir problemesh që kolegët e mi këtu i ngritën, të cilat kanë të bëjnë me keqmenaxhimin, por kanë të bëjnë edhe me abuzimin e hapur se si janë krijuar këto borxhe dhe pse fillojnë të vazhdojnë të rriten për faktin e menaxhimit që nga personeli, interesat politike dhe më pas realiteti konkret i ujësjellësit që u përmendën edhe këtu, pra mënyra se si trajtohen, punësohen me fushata për interes, prokurimet që bëhen. Ky është një moment tjetër që duhet parë, pra jo vetëm tek ujësjellësi për prokurimet që bëhen, por edhe të strukturat e sistemit energjetik, qoftë tek OSHEE-ja, qoftë te KESH-i. Këto prokurime të fondeve publike bëhen për interes, siç u tha këtu nga kolegu përpara, për investime, apo bëhen edhe për qëllime tërësisht sipërfaqësore që nuk kanë të bëjnë në thelb as me menaxhimin dhe as me sigurinë e sistemit energjetik, nuk kanë të bëjnë as me rrjetin e teknologjisë dhe as me mirëmenaxhimin? E përsëris edhe një herë, meqenëse ne flasim për një politikë brenda rajonit të Ballkanit, mora dy referenca, Kosovën dhe Maqedoninë, të cilët përdorin një bursë që është bursa e Budapestit në rastin e shitjeve, kurse në praktikë tona me idetë e marrjeve të ofertave, me *email-e* e të tjera, lë gjithmonë shteg për mungesë transparence, por edhe për abuzime. Për më tepër, e përsëris, dhe shpresoj që të ketë të drejtë drejtori apo përfaqësuesi i ministrisë, që nuk futen ndërmjetës për blerjen nga KESH-i të energjisë individë të caktuar që pasurohen brenda ditës për

transaksionin dhe bëjnë shkëmbimin, në vend që atë energji, e cila prodhohet, të blihet, të menaxhohet brenda sistemit energjetik në favor të konsumatorëve dhe në favor të enteve publike dhe private, në mënyrë që të ulim kostot, të cilat kanë të bëjnë me situatën e tanishme energjetike. Megjithatë, shpresoj dhe besoj se ne duhet të marrim përsërisi si Komisioni i Ligjeve, por edhe si parlament një analizë pak më të hollësishme të të gjitha këtyre problemeve që janë brenda sistemit energjetik, edhe të zinxhirit të marrëdhënieve me sistemin energjetik. Kjo është detyra jonë, në mënyrë që të mos bëjmë debate pa vlerë me njëri-tjetrin, por sidomos të mos kemi një raport të panjohur me problematikën që ka sistemi energjetik apo edhe zinxhiri i marrëdhënieve të enteve private publike me sistemin energjetik.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Mediu!

Fjalën e ka zoti Sula.

**Dashnor Sula** – Faleminderit, zonja kryetare!

Edhe unë dua të ndalem në disa probleme që të gjithë kolegët i prekën, absolutisht pa dashur t'ju tërheq vëmendjen juve, por është e disata herë që, sapo fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve, fjala e parë që ju na drejtoni është “jemi komision për dhënie mendimi, duhet të shikojmë vetëm përputhshmërinë e projektligjit, i cili paraqitet nga qeveria, me Kushtetutën”. Domethënë, ne ta shikojmë vetëm në lidhje me Kushtetutën. Pa diskutim që ato janë në pajtueshmëri me Kushtetutën, kështu që nuk duhet të diskutojmë dhe të merremi me asnjë lloj gjëje tjetër. Shpreh keqardhjen për ngjarjen dhe incidentin, i cili ndodhi këtu, nuk dua ta zgjas më tej, por respekti ndaj parlamentit dhe ndaj deputetëve dihet, por njerëzit e ekzekutivit e ndjejnë veten superior, sigurisht nga mirëqenia e madhe që kanë, prandaj kjo ndjesi do të jetë gjithmonë në Komisionin e Ligjeve.

Kthehemi te problemi që po diskutojmë tani. Siç e tha edhe zoti Mediu dhe të gjithë të tjerët e cekën, Kryeministri ynë e ka thënë disa herë, madje e ka trumbetuar fort, që opozita duhet të bëjë një moratorium për 10 vjet për sa i përket problemit të energjisë elektrike, të cilën ai e ka zgjidhur me mjaft efikasitet siç thotë. Por në të vërtetë edhe sot e pamë, e kemi dëgjuar dhe jemi dëshmitar të këtij realiteti, që është mjaft i dhimbshëm, për gjendjen katastrofike në të cilën ndodhet OSHEE-ja.

Nëse në vitin 2013 OSHEE-ja kishte një borxh rreth 70 milionë euro, nëse nuk gaboj, por po themi 90 milionë euro, sot borxhi ka arritur në 200 milionë euro. Këto borxhe janë nga ndërmarrjet si ujësjellësi apo operator të tjerë publik.

Problemi më i madh i akumulimit të këtyre borxheve nga kompania ujësjellës kanalizime, jam i bindur me 1000%, është numri i lartë të punonjësve që punësohen. Madje nga 2013 e mbrapa, nëse nuk gaboj, numri i punonjësve në ujësjellës kanalizime është

dhjetëfishuar, duke futur militantë partie, ndërkohë që kur nuk paguajnë dot detyrimet OSHEE-së. Çfarë kuptimi ka?

Unë nuk dua të përmend emirin e asnjë bashkie në qarkun e Elbasanit, por po ju them se janë 3 bashki, të cilat për efekt të mbifryrjes së organikave në administratë nuk paguajnë dot rrogat prej 3-4 muajsh. E njëjta situatë vazhdon njëra pas tjetrës dhe vijmë pastaj këtu ku jemi.

Sigurisht, siç e thanë edhe kolegët, bëhet fjalë për *cash flow* e OSHEE-së, por të mos harrojmë që në verë OSHEE-ja ka marrë një kredi nga qeveria me rreth 40 milionë euro, për importin e energjisë, por ajo ka filluar të akumulojë më shumë borxhe të papaguara dhe veçanërisht ndaj tatimeve.

Jo paqëllim i bëra një pyetje drejtorit të OSHEE-së për sa i përket informacionit që ka OSHEE-ja për prodhimin e Bitcoin. E tha drejtori i OSHEE-së publikisht, e dëgjuam të gjithë, që bëhej fjalë për dy raste të kapura një në Tiranë dhe një në Fushë-Krujë, por ju garantoj dhe po e përsëris se ka me dhjetëra që operojnë në fushën ilegale të prodhimit të Bitcoin. Këmbëngul për një arsye shumë të thjeshtë, sepse nuk është çështja e vjelljes së energjisë elektrike nga një qytetar apo subjekt i vogël, por sasia e konsumimit të energjisë elektrike, nga këto aktivitete që në mënyrë ilegale prodhojnë Bitcoin, është jashtëzakonisht e madhe. Të jeni të sigurt që ky aktivitet nuk mund të mbështetet nga një faturist i thjeshtë apo një drejtor i thjeshtë fshatit apo vendit ku prodhohen, por ka mbrojtje policore të shtetit dhe nga persona të lartë të OSHEE-së.

Mua më vjen keq, ashtu siç tha edhe drejtori, që nuk ka për ta rritur një gjë e tillë, por mbështetja është e forte dhe politike. Këto janë kambana alarmi dhe po e them përsëri që OSHEE-ja duhet të bëjë maksimumin t'i ndërpresë këto gjëra.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Sula!

Fjalën e ka zonja Felaj.

**Ermonela Felaj** – Dua të them dy fjalë, të parën e kam procedurale. Do të ishte në të mirën e komisionit që pas çdo pyetje të jepej përgjigje, kështu edhe debati mbahet gjallë dhe ka sens. Në fund mundet edhe të humbasin pyetjet që janë bërë gjatë kohës, por ndërkohë mund të lindin edhe pyetje pas përgjigjeve të dhëna. Prandaj është normale që ta respektojmë Rregulloren në këtë pikë, me përjashtim të rasteve kur biem dakord që t'i konsumojmë së bashku pyetjet dhe përgjigjet, kur edhe tema është e tillë që ne të gjithë nuk kemi shumë diskutime.

Për sa i takon marrëveshjes në fjalë, dua që të ngre dy pyetje. E para, a duam që në interes të OSHEE-së të kemi një kredi që nëpërmjet saj ajo të na sigurojë energji? Besoj se



përgjigjja e të gjithëve këtu do të ishte “po”, sepse të gjithë jemi konsumator, familjar ose individual dhe patjetër që nuk duam të rikthehemi në eksperiencën e viteve të mëparshme, ku kemi qëndruar me ditë dhe orë të tëra pa energji elektrike.

OSHEE-ja dhe kompani të tjera të ngjashme janë kompani shtetërore, sigurisht që edhe ata kanë problematikat e tyre të menaxhimit dhe të administrimit, por nga ana tjetër të mos harrojmë se janë të rëndësishëm, sepse janë amortizator social, prandaj duhet të mbeten të tilla. Unë besoj se duhet të kuptojmë nga performanca e këtyre kompanive, por edhe t’u japim mbështetje, sepse janë amortizator social. Në fund të ditës shteti duhet të ketë disa instrumente në dorë, që për kategorinë e atyre që nuk ia dalin dot vetë me jetesën, t’i mbështesë edhe OSHEE-ja. Pra, në këtë kuptim, nga të dhënat që u paraqitën nga përfaqësuesit e ministrisë dhe nga administratori i OSHEE-së, unë besoj se duhet ta mbështesim këtë marrëveshje, sepse është në të mirë të punës së OSHEE-së.

Reforma që u bë në lidhje me energjinë elektrike ka pasur efektet e saja pozitive. Një pjesë jona këtu vijmë nga organi i prokurorisë dhe e di shumë mirë që skema e vjelljes së energjisë elektrike ka qenë një skemë shumë e përhapur. Ne nuk e shpikëm ne vjelljen e energjisë elektrike, ajo ka ndodhur, ndodh dhe do të ndodh, por e rëndësishme është të ndërhyhet dhe të parashikohet dënimi përkatës për të frenuar vjedhjen.

Nga ana tjetër edhe investimet në sistem, e dimë të gjithë, janë të domosdoshme. Kemi sot stacione elektrike që datojnë që nga koha e marrëdhënies së Shqipërisë me Republikën Kineze, prandaj të mos pretendojmë që nuk ka humbje ose nuk shfrytëzohet kjo pjesë...

*(Debate pa mikrofon)*

Ju lutem, kolegë, sepse mikrofonin punon dhe mbledhja po regjistrohet.

**Klotilda Bushka** – Mbledhja vazhdon dhe po regjistrohet.

*(Debate pa mikrofon)*

Zonja Felaj, vazhdoni, sepse mbledhja po regjistrohet.

**Ermonela Felaj** – Kjo tregon se i kemi marrë masat në një mënyrë të tillë që të vazhdojmë të kemi energji dhe puna të mos ndërpritet.

Duke shpresuar që në thelb ne jemi për mbështetjen e kësaj marrëveshje dhe për ta lejuar OSHEE-në të ketë një disponueshmëri të hollash me qëllim që të sigurojë në vijimësi furnizimin për çdo konsumator, unë ju ftoj që ta votojmë këtë marrëveshje.

*(Debate pa mikrofon)*

**Klotilda Bushka** – Dakord, kolegë, me sa shikoj nuk ka më diskutime. Nga sekretaria më njoftojnë se mbledhja vijon të regjistrohet dhe të shfaqet *live*. Unë nuk e di përse nuk kemi ndriçim ndërkohë që mikrofonat punojnë.

Meqenëse nuk ka diskutime e hedhim në votim projektligjin. Kush është pro në parim për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për marrëveshjen e huas, ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a. (OSHEE), dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e OSHEE-së për reagimin ndaj krizës së pandemisë COVID-19”? 14 vota pro. Kundër? Nuk ka...

**Xhemal Qefalia** – Të lutem kryetare, a mund të na e sqaroni...

**Klotilda Bushka** – Të lutem zoti Xhemal, sepse po votojmë projektligjin.

**Xhemal Qefalia** – Po a e kalove votimin në parim?

**Klotilda Bushka** – Tani jemi në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord me nenin 1?

**Xhemal Qefalia** – Përse nuk janë prezent zëvendësministri dhe drejtori i OSHE-së?

**Klotilda Bushka** – Janë në komisionin tjetër zoti Qefalia.

Neni 1. Kush është pro? 13 vota pro.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? 14 vota pro. Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për marrëveshjen e huas, ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a. (OSHEE), dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e OSHEE-së për reagimin ndaj krizës së pandemisë COVID-19”.

Përpara se të kalomë te çështja tjetër do të ndërpresim mbledhjen 5 minuta sa të shikojmë se çfarë problemi teknik kemi, sepse mikrofonat punojnë, por nuk kemi ndriçim.

Faleminderit!



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.10.2021, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Klotilda Bushka - kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për zbatimin e programit për përgatitjen e studimeve të fizibilitetit dhe hartimit në nivel përfundimtar, si dhe studimin e impaktit mjedisor në sektorin e infrastrukturave, ratifikuar me ligjin nr. 86/2016”.

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e vakancës së katër anëtarëve të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit.

#### **Marrin pjesë:**

Klotilda Bushka, Klevis Xhoxhi, Ermonela Valikaj (Felaj), Saimir Hasalla, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Eduard Ndreca, Alqi Bllako, Bradhyl Kollçaku, Lavdrim Krrashi, Oerd Bylykbashi, Gazment Bardhi, Enkelejd Alibeaj, Dhurata Tyli (Çupi), Saimir Korreshi, Greta Bardeli, Dashnor Sula, Fatmir Mediu, Aurora Mara, Elda Hoti, Erisa Xhixho, Gerta Duraku, Toni Gogu, Gledis Çeliku, Bledion Nallbati,

#### **Mungojnë:**

Damian Gjikhuri, Jurgis Çyrbja dhe Fatmir Xhafaj.

#### **Të ftuar:**

Ilir Bejtja – Zëvendësministër e Infrastrukturës dhe Energjisë

Kledia Ngjela – Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Elton Sevrani – Drejtor në OSHEE

Ardian Çela – Administrator i OSHEE-së

Enkelejda Muçaj – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Thimjo Plaku – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Teuta Balili – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Erald Elezi – Drejtor në ARRSH

**Klotilda Bushka** – Kishim një defekt teknik të Kuvendit.

Vazhdojmë, të nderuar kolegë, me rendin e ditës: shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për zbatimin e programit për përgatitjen e studimeve të fizibilitetit dhe hartimit në nivel përfundimtar, si dhe studimin e impaktit mjedisor në sektorin e infrastrukturave, ratifikuar me ligjin nr. 86/2016”.

Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ishte zonja Enkelejda Muçaj, zëvendësministre, e cila është larguar për në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, sepse ne na zgjati shumë pika e parë, por është zoti Thimjo Plaku, drejtor në këtë ministri.

Mirë se erdhët, zoti Plaku! Fjala është për ju, për të bërë një prezantim të kësaj nisme. Ne jemi komision për dhënie mendimi. Relator do të jetë zoti Toni Gogu.

**Thimjo Plaku** – Përshëndetje!

Projektligji që po marrim në shqyrtim synon ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash për zbatimin e programit për përgatitjen e studimeve të fizibilitetit dhe hartimin në nivel përfundimtar, si e studimin e impaktit mjedisor. Këtu bëhet fjalë për një ndryshim të ligjit të ratifikuar në vitin 2016 për hartimin e 3 studimeve të fizibilitetit për segmente rrugore, të cilat ishin: bajpasi i Elbasanit, rruga Kashar-Vaqarr-Rrogozhinë, një aks i ri, që mendohet të ndërtohet, si dhe zgjerimi i rrugës Milot-Shkodër. Për shkak të ndryshimit të prioriteteve, për shkak të hyrjes së korridoreve të reja europiane dhe të përcaktimit të korridorit Adriatiko-Jonian ose të autostradës Adriatiko- Joniane, si zgjatim indikativ i këtij korridori, i korridorit mesdhetar në Ballkanin Perëndimor, ndryshuam prioritetet dhe pjesa Milot-Shkodër, si dhe pjesa e rrugës së re që mendohet në Kashar-Vaqarr dhe Rrogozhinë kanë kaluar tashmë me projektet e WBIF-t për t’u ndërtuar në kuadrin e korridorit Adriatiko-Jonian, autostrada Adriatiko-Joniane. Për këtë qëllim bëhet edhe ndryshimi i kësaj marrëveshjeje, sepse janë futur në vend të Milot-Shkodër është futur rruga Elbasan-Qukës dhe, në vend të Kashar-Rrogozhinës, është futur bajpasi i Beratit, për shkak të prioriteteve të qeverisë në sektorin e turizmit.

Ndryshimet e bëra janë në koston e secilit prej studimeve. I gjithë projekti është prej 2,1 milionë euro, i cili jepet nga Kooperacioni Italian. Në përbërje të këtij projekti janë edhe 150 mijë euro për financimin e njësisë së implementimit të këtyre tri projekteve të rëndësishme.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Plaku!

Po, zoti Gogu, në cilësinë e relatorit.

**Toni Gogu** E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar kolegë,

Marrëveshja ndryshuese që vjen sot për shqyrtim, ku ne jemi komision për dhënie mendimi, vjen në zbatim të kalendarit të punës së Kuvendit dhe të komisionit. Ajo ndryshon një marrëveshje bazë, që është marrëveshja e miratuar në vitin 2016. Pas saj është marrëveshja e financimit që është marrëveshja e vitit 2018. Marrëveshja ndryshuese është kjo që kemi përpara, e cila ka ardhur tërësisht në zbatim të Kushtetutës, kreut për ratifikimin e marrëveshjeve, por edhe në zbatim të Rregullores së Kuvendit me të gjitha elementet e duhura.

Ajo çfarë propozon marrëveshja ndryshuese, e cila është edhe me shkëmbim notash, ka filluar nga ministria jonë përkatëse dhe është kërkuar ndryshimi përkundrejt ministrisë italiane, për shkak të ndryshimit të emërtimeve, të akronimeve, saktësisht të financimit dhe ndryshimeve që përmendi përfaqësuesi i ministrisë për shkak të rakordimit të prioritetëve. Pra, janë zëvendësuar disa elemente se ku do të fokusohen studimet e fizibilitetit. Pa humbur kohë, meqenëse qoftë elementi ligjor, qoftë ai procedural i Rregullores janë plotësuar, propozoj ta miratojmë këtë marrëveshje ndryshuese.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, koleg!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Mendova se rakordua dhe nuk kishte më diskutime.

Zonja Çupi ka një pyetje dhe zonja Bardeli ka diskutim.

**Dhurata Çupi** – Faleminderit!

Së pari, falënderoj edhe përfaqësuesit e ministrisë për prezencën! Pyetja është: në këtë projektligj që keni sjellë, ndoshta jam e gabuar, por në asnjë paragraf nuk kuptoj nëse kjo ka të bëjë me një koncesion, me blerje apo me donacion të këtyre projekteve?

E dyta, tashmë është i konsoliduar një opinion i përgjithshëm se shumë humbje jete nga aksidentet rrugore janë edhe për shkak të mungesës së sigurisë rrugore. A mund të na thoni se sa prej këtyre aksidentëve i keni të statistikuara se ndodhin vetëm për shkak të mungesës së sigurisë rrugore?

Si përfaqësues i ministrisë, por edhe unë si përfaqësuese e qarkut të Dibrës, a mund të na jepni një informacion, tashmë është bërë jashtëzakonisht problem dhe dëshpërues ky fakt që nuk merret asnjë masë nga qeveria për rrugën Rrëshen-Burrel. Investimi është mbaruar në vitin 2013, është marrë në dorëzim dhe askush nuk investon që nga viti 2013. Kjo rrugë tashmë është e pakalueshme, e paaksesueshme dhe e shkatërruar.

**Klotilda Bushka** – Zoti Plaku, nëse keni ndonjë përgjigje?

**Thimjo Plaku** – Po ju sqaroj se kjo është një kredi e butë e qeverisë italiane, e Kooperacionit Italian, interesat janë zero. Do të paguhet për një periudhë prej 26 vjetësh.

**Dhurata Çupi** – Pra, është kredi?

**Thimjo Plaku** – Po, kredi, por me kushte të buta, me zero për qind interes. Do të paguhet për 26 vjet dhe ka një periudhë faljeje prej 6 vjetësh. Po të llogarisim 2,1 milionë euro, pagesat ditore janë të papërfillshme, më pak se 100 mijë euro në vit.

Duke llogaritur edhe interesin që kemi për maturimin e projekteve për investime, ku është e domosdoshme kryerja e studimeve të fizibilitetit dhe studimeve të ndikimit të ndërtimit të rrugëve në mjedis, mund ta konsiderojmë fare mirë si një grant.

*(Deputetja Çupi flet pa mikrofon.)*

Nuk mund të themi koncesion. Problemi është ky: këtu kemi një marrëveshje ndryshuese, pra ndryshon një marrëveshje e mëparshme. Shpeshherë materiali u referohet vetëm ndryshimeve dhe, po të mos shikosh marrëveshjen e parë, shumë gjëra nuk kuptohen.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Plaku!

Zonja Bardeli.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Thimjo Plaku** – Për rrugën Rrëshen-Burrel nuk e di, nuk kam informacion përse bëhet fjalë, sepse përfaqësuesit e ARSH-së kaluan në komisionin tjetër.

**Klotilda Bushka** – Zoti Plaku, mund ta mbani shënim pyetjen e zonjës Çupi për një përgjigje me shkrim?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Zoti Korreshi, nuk janë ata të ARSH-së. Ia kam dhënë fjalën zonjës Bardeli.

**Greta Bardeli** – Zonja Kryetare, ju falënderoj për fjalën!

Gjej rastin të parashtrij kërkesën e opozitës që në këto komisione të jetë i pranishëm një përfaqësues politik i ministrisë, sepse e shoh më të udhës që njëri nga zëvendësministrat...

*(Ndërhyrje nga salla)*

Atëherë, unë gjej rastin të falënderoj palën italiane për financimin e projektit apo bashkëfinancimin për infrastrukturën rrugore, por, sikurse thuhet edhe në relacion, prioritetet kanë ndryshuar. Unë dua të theksoj se është një nga prioritetet, i cili lëngon tashmë. Në relacionin tuaj ju thoni që do t'u jepet prioritet zonave të Veriut, për shkak se janë zona të varfra dhe shikoj që kemi një zëvendësim të aksit rrugor Milot–Shkodër. Arsyet pse ka ndryshuar ky relacion që ju paraqisni, duke menduar se ky është një nga akset kryesore ose, më mirë të themi, është porta hyrëse e Korridorit Blu, që ju i thoni Adriatik- Jonian.

Si deputete e qarkut Shkodër, sjell në vëmendjen tuaj shqetësimin e vazhdueshëm që ka ai aks, jo vetë për shkak të aksidenteve të shpeshta që ndodhin aty deri në humbjen e jetës, por ky aks është një nga akset më të frekuentueshme dhe më të prekshme.

Duke pasur parasysh edhe periudhën e verës, kohën kur ky aks përshkohet nga qytetarë të ndryshëm, edhe nga ato të cilët vijnë për të kaluar disa ditë pushime nga Kosova apo nga vendet e tjera të BE-së, detyrohen të rrinë në trafik 5-6 orë në periudhën e verës.

Nuk e shikoj të udhës që ju ta zhvendosni këtë investim dhe ta çoni diku tjetër, edhe pse ndoshta mund të kenë prioritet ato zona, por e shikoj një thirrje të vazhdueshme të barorëve të qarkut të Shkodrës, por jo vetëm (edhe të qarkut të Lezhës), që ky investim të bëhet sa më shpejt dhe të zgjerohet rruga apo aksi rrugor, i cili përshkon zonën Milot–Shkodër.

Ju kujtoj këtu që ai aks nuk është prekur që përpara 20 vjetëve, qysh kur erdhi Kryeministri Berlusconi dhe përuroi urën e re të Milotit, prandaj shikojeni që ta vini në prioritet e ministrisë suaj.

Si udhëtare e rregullt e asaj rruge, mund të them se po patëm pak fat, ajo rrugë mund të përshkohet për një afat kohor 2 orë e gjysmë, ndërkohë që para 8 vjetësh ajo rrugë mund të përshkohej në 1 orë e gjysmë. Unë mendoj që, meqenëse po i jepni shumë prioritate Korridorit Blu, korridorit Adriatik-Jonian, të keni në vëmendje që të bëhet sa më shpejt investimi i zgjerimit të kësaj rruge, sepse është shumë e domosdoshme jo vetëm për qytetarët që kryejnë shërbime të ndryshme me kryeqytetin, por edhe për faktorët e tjerë, që janë shumë të rëndësishëm në zhvillimin e këtyre zonave, sikurse janë faktorët ekonomikë dhe turizmi.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zonja Bardeli!

Në lidhje me çështjet për të cilat zoti Plaku nuk kthen dot përgjigje, unë do t'i kërkoj sekretarisë që të mbajë shënim, edhe një pyetje që ka zoti Korreshi më pas dhe t'ia kërkojmë përgjigjet ARRSH-së.

Kam një çështje. Unë nuk hyj tek ata kolegë, të cilët u kujtojnë disave se janë për herë të parë këtu dhe nuk njohim rregullat, përkundrazi, të pakët për anëtarët e Komisionit të Ligjeve, e kam shprehur edhe personalisht me secilin nga ju, por po ua them edhe këtu, se për çdolloj nevojë për të ushtruar më së miri detyrat, kushdo nga ju, qoftë edhe për herë të parë mund të mbështetet edhe te këshillat dhe ndihma ime.

Për sa u takon pyetjeve që bëhen këtu dhe nuk merren përgjigje, thjesht po ju vë në dijeni se, në bazë të ligjit “Për statusin e deputetit”, keni drejtë edhe t'u bëni pyetje institucioneve, të cilat kalojnë nëpërmjet sekretarisë dhe, sigurisht, komisioni përkatës mund të ketë disa deputetë që kanë të njëjtën pyetje dhe mund të bëhen edhe dy-tre deputetë.

Këto janë mjete, të cilat na ndihmojnë të gjithëve si deputetë që ta bëjmë sa më mirë punën tonë në përfaqësim të interesave të komuniteteve ku kemi marrë votat tona për t'i përfaqësuar.



Ju falënderoj për diskutimet konstruktive!

Do ta hedh në votim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për zbatimin e programit për përgatitjen e studimeve të fizibilitetit dhe hartimit në nivel përfundimtar dhe studimin e impaktit mjedisor në sektorin e infrastrukturave, ratifikuar me ligjin nr. 86/2016”.

Kush është dakord në parim?

Të gjithë të pranishmit janë pro.

Sekretaria të numërojë votat!

Kush është kundër? Asnjë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te votimi nen për nen.

Neni 1.

Kush është pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kush është pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Të gjithë dakord.

Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Të bëhet gati nga relatori dhe nga këshilltarët raporti për t’i kaluar komisionit përgjegjës.

Faleminderit, zoti Plaku! Jeni i lirë të shkoni.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 26.10.2021, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e vakancës së katër anëtarëve të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit”.

**Marrin pjesë:**

Klotilda Bushka, Klevis Xhoxhi, Ermonela Valikaj (Felaj), Saimir Hasalla, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Eduard Ndreca, Alqi Bllako, Bradhyl Kollçaku, Lavdrim Krrashi, Oerd Bylykbashi, Gazment Bardhi, Enkelejd Alibeaj, Dhurata Tyli (Çupi), Saimir Korreshi, Greta Bardeli, Dashnor Sula, Fatmir Mediu, Aurora Mara, Elda Hoti, Erisa Xhixho, Gerta Duraku, Toni Gogu, Gledis Çeliku, Bledion Nallbati,

**Mungojnë:**

Damian Gjikhuri, Jurgis Çyrbja dhe Fatmir Xhafaj.

**Klotilda Bushka** – Kemi edhe një pikë tjetër në rendin e ditës që jua ka shpërndarë sekretaria: shqyrtimin e projektvendimit “Për shpalljen e vakancës së katër anëtarëve të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”.

Spektori i Monitorimit të Institucioneve na ka informuar se është drejt përfundimit mandati i 4 anëtarë të Autoritetit për Informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Ne jemi komision përgjegjës.

Sot, duke qenë se jemi vënë në dijeni për mbarimin e mandatit të 4 anëtarëve, zonjës Gentiana Sula, zotit Altin Hoxha, zotit Marenglen Kasmi dhe zotit Simon Mirakaj, jemi në kushtet që ne duhet ta shpallim vakancën. Pra, ne vetëm shpallim vakancën e 4 anëtarëve.

*(Ndërhyrje nga salla.)*

Sipas një memoje,. Jua kemi shpërndarë, zonja Çupi.

4 vetave u ka mbaruar mandate. Zoti Daut Gumeni është emëruar anëtar me vendimin nr. 82/2016 dhe është një vend vakant.

Keni një projekt, i cili ju është shpërndarë. Ne thjesht biem dakord që të miratojmë këtë projektvendim dhe të shpallim vakancat.

**Gazment Bardhi** – Në shkresë thuhet se janë 4 mandate që kanë përfunduar tani dhe një mandat, për të cilin ka nisur procedura, por ka dështuar, që është mandati i zotit Gumeni, kështu që janë 5 vende vakante.

**Klotilda Bushka** – Është shpallur një herë ajo vakancë. Është në proces. Nuk mund ta shpallim prapë.

**Gazment Bardhi** – Ka dështuar procedura.

**Klotilda Bushka** – Komisioni i Ligjeve ka një vendim për shpalljen. Ky vendim sot është për shpalljen e 4 vendeve vakante për anëtarë të Autoritetit për Informimin dhe Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

*(Ndërhyrje nga salla)*

E ngrini me të drejtë si shqetësim. Le ta sqarojmë. Janë 5 vakanca, 4 janë në kompetencë të Kuvendit për t’u shpallur, 1 është në kompetencë e Këshillit të Ministrave dhe për këtë arsye edhe projektvendimi, që ju është shpërndarë, është për shpalljen e vakancës së 4 anëtarëve të Autoritetit për Informimin dhe Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Në fakt, ka qenë e shkruar në material, por për ta qartësuar dhe për ta fiksuar në procesverbalin e mbledhjes.

A jeni dakord me projektvendim? Dakord.

Faleminderit!

Mbledhja mbyllet.

Mbledhja e radhës do t'ju njoftohet.

## **MBYLLET MBLEDHJA**